

MANUALI I PUNËS

*për stafet sociale të Bashkisë Kavajë
që punojnë me fëmijët
me aftësi të kufizuar*



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Programi Rajonal mbi Demokracinë
Vendore në Ballkanin Perëndimor





Manuali i punës për stafet sociale të Bashkisë Kavajë që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuar



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Programi Rajonal mbi Demokracinë
Vendore në Ballkanin Perëndimor



QERSHOR, 2024

Ky material është prodhuar për stafet sociale të Bashkisë Kavajë që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuar në kuadër të projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 - Re-LOaD2”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Autorë:

Edlira Ngjeci Shima, PhD

Olta Qejvani PhD candidate

Ky projekt mbështetet nga:

#ReLOaD

Ky projekt synon të sigurojë që fëmijët me AK në Bashkinë Kavajë të përfitojnë nga përmirësimi i sistemit të shërbimeve të kujdesit social.

Hyrje

Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes (ACDF) në kuadër të zbatimit të projektit “Vlerëso-Fuqizo-Vepro: stafe sociale më të fuqizuara përballë shërbimeve të kujdesit social për fëmijët me aftësi të kufizuara në Bashkinë Kavajës”, Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD, i cili financohet nga Bashkimit Europian dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)”, ka ndërmarrë përsipër hartimin e manualit për punonjësit e shërbimeve sociale, të qendrave ditore në menaxhimin e rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Manuali për punonjësit e shërbimeve sociale që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara përmban një qasje të ndjeshme, të përkushtuar dhe të përgatitur për të kuptuar dhe mbështetur nevojat specifike të këtyre fëmijëve. Më poshtë janë disa parime bazë mbi të cilat është konceptuar ky manual:

1. **Përkushtim ndaj diversitetit dhe përshtatshmërisë:** Një qasje të diversifikuar dhe të përshtatshme që i respekton dhe i përmbush nevojat e çdo fëmijeje me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin marrjen parasysh të ndryshimeve të mundshme në mjedis dhe programet e tyre për të siguruar që ata të kenë qasje të barabartë në shërbimet dhe aktivitetet.
2. **Komunikim i qartë dhe i mirëkuptueshëm:** Komunikimi është thelbësor për të kuptuar nevojat dhe dëshirat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përdorni mënyra alternative të komunikimit, siç janë gjuhët e shenjave, figura, ose teknologjitë asistuese nëse është e nevojshme.
3. **Ndërtimi i besimit dhe sigurisë:** Krijoni një mjedis të sigurt dhe mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ata duhet të ndjehen të sigurt dhe të vlerësuar në mjedisin tuaj për të ndjekur zhvillimin e tyre me sukses.
4. **Ndërtimi i aftësive të pavarësisë:** Inkurajoni dhe mbështesni pavarësinë dhe aftësitë e fëmijëve për të kryer detyrat e tyre të përditshme dhe për të zhvilluar vetëbesimin.
5. **Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin:** Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin është i rëndësishëm për të siguruar mbështetje të plotë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kuptoni nevojat e tyre dhe ofroni burime dhe udhëzime për të ndihmuar në përmirësimin e jetës së tyre në familje dhe në shoqëri.
6. **Përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve asistuese:** Përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve asistuese mund të ndihmojë në përmirësimin e qasjes dhe pavarësisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Sigurohuni që të keni njohuri dhe aftësi për të përdorur këto mjete në mënyrë efektive.
7. **Ndërtimi i një mjedisi të përfshirjes:** Sigurohuni që të gjithë fëmijët të ndjehen të përfshirë dhe të vlerësuar në mjedisin tuaj. Inkurajoni miqësitë dhe bashkëpunimin mes fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara.
8. **Përmirësimi i aftësive profesionale dhe vazhdimi i zhvillimit personal:** Kërkoni rregullisht trajnime dhe zhvilloni aftësitë tuaja teknike për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin njohuritë e reja mbi praktikat më të mira dhe strategjitë për të përmbushur nevojat e tyre në mënyrë efektive.
9. **Respektimi i integritetit dhe autonomisë:** Respektoni integritetin dhe autonominë e fëmijëve

me aftësi të kufizuara dhe sigurohuni që të ndjekin qëndrimet dhe dëshirat e tyre sa është e mundur.

10. **Monitorimi dhe vlerësimi i progresit:** Monitoroni progresin e fëmijëve dhe sigurohuni që të përdorni vlerësimin e qëndrueshëm për të identifikuar nevojat e tyre dhe për të zhvilluar plane të përshtatshme për të mbështetur zhvillimin e tyre të përgjithshëm.

Ky manual është një orientim teorik dhe praktik për punonjësit e shërbimeve sociale për të menaxhuar në mënyrën e duhur rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, sipas standardeve të kërkuara dhe nevojave të tyre specifike.

Metodologjia

Ky manual mund të përdoret nga punonjësit e shërbimeve sociale, të qendrave ditore si dhe të personave të tjerë të interesuar si: politikbërës, ekspertë, kërkues shkencorë etj për të gjetur aspekte teorike dhe praktike se si mund të ofrohen shërbimet përkatëse ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Manuali ka synuar që:

- a) Të ofrojë burimet e literaturës, informacionit si dhe dokumentat strategjikë, politikë dhe ligjorë që shërbimet sociale mund të referojnë punën e tyre për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- b) Të ofrojë parimet e procesit dhe menaxhimit të rasteve specifike.
- c) Të paraqesë hapat e procesit të menaxhimit të rasteve duke evidentuar aktorët dhe llojet e shërbimeve.
- d) Të parashtrijë elementë të tjerë konceptualë apo praktikë që lidhen me ofrimin e shërbimeve.

Manuali është bazuar në literaturën bashkëkohore shqiptare dhe atë ndërkombëtare/evropiane duke krijuar lidhjet përkatëse dhe të duhura me realitetin shqiptar. Një aspekt i rëndësishëm i metodologjisë mbi të cilin është ngritur ky manual ka qenë 'feedback' i marrë nga takimet e realizuara me stafet e shërbimeve sociale, të qendrave Ditore në Bashkinë Kavajë si dhe nga identifikimet e rasteve konkrete.

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Metodologjia	5
Përmbajtja	7
Lista e shkurtesave	9
I. Baza ligjore dhe dokumentat strategjikë për fëmijët me aftësi të kufizuara	11
1.1 Ligjet kryesore në Shqipëri për fëmijët me aftësi të kufizuara.....	11
1.2 Burimet mbi aktet ligjore	13
1.3 Disa dokumenta strategjikë (të tjerë) të rëndësishëm	15
1.4 Parimet e përgjithshme që udhëheqin punën e stafeve të shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara.....	15
II. Instrumentet dhe procesi i diagnostifikimit	17
2.1. Koncepte të përgjithshme të instrumentave dhe procesit të diagnostifikimit	17
2.2 Instrumentat dhe hapat sipas OBSH (Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetësisë)	18
2.3. Aplikimi i diagnostifikimit në Shqipëri	19
III. Llojet e shërbimeve	23
3.1 Parimet e ofrimit të shërbimeve	23
3.2 Disa aspekte/sfida specifike të Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar	24
3.3 Llojet e shërbimeve	24
IV. Strukturat bashkëpunuese për ofrimin e shërbimeve shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara	30
V. MENAXHIMI I RASTIT	37
5.1 Koncepti i menaxhimit të rastit	39
5.2 Procesi i menaxhimit të rastit.....	39
5.2.1 Identifikimi	40
5.2.2 Raportimi.....	40
5.2.3 Procesi i vlerësimit, identifikimi i rrezikut	41
5.2.4 Planifikimi i Përkujdesit dhe i Mbrojtjes	51

5.2.5 Zbatimi monitorimi dhe rishqyrtimi i PIM-it	54
5.2.6 Mbyllja e Rastit	55
Annex.....	58
Formatet e APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË AK	58
Formulari i Shqyrtimit të Progresit / Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës	59
Bibliografi dhe referenca	60

Lista e shkurtesave

ACDF	Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes
AK	Aftësi e Kufizuar
BE	Bashkimi European
KM	Këshilli i Ministrave
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
OBSSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. Baza ligjore dhe dokumentat strategjikë për fëmijët me aftësi të kufizuara

Në këtë rubrikë do të gjeni një panoramë të plotë të kuadrit ligjor dhe strategjik që mund të konsultoni gjatë punës suaj për fëmijët me aftësi të kufizuara, burimet kryesore, parimet që ligjet dhe politikat përkatëse promovojnë si dhe një përshkrim të dokumentave strategjikë aktualë të cilat luajnë një rol kryesor gjatë aktivitetit tuaj. Edhe pse ligjet dhe zbatimimi i tyre s'është mjaftueshëm për menaxhimin e suksesshëm të rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, një botëkuptim sa më i qartë, konkret dhe i duhuri i kësaj panorame është thelbësore në punën e stafëve të shërbimeve sociale dhe aktorëve të tjerë në tërësi.

1.1 Ligjet kryesore në Shqipëri për fëmijët me aftësi të kufizuara

Në rast se do na duhet që të eksplorojmë apo gjejmë një dokument ligjor, i cili i adresohet fëmijëve me aftësi të kufizuara nga perspektiva e menaxhimit që bëjnë shërbimet sociale, duke përfshirë qendrat ditore, do duhet që të kushtojmë vëmendje njëkohësisht në:

a. legjislacionin dhe politikat për shërbimet sociale/qendrat ditore e të tjera të ngjashme me to ¹

Kjo paketë legjislative është e përditësuar në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror. Kjo faqe mund të aksesohet falas nga secili vizitor i interesuar. Aktet ligjore të cilat gjejnë zbatim të gjerë dhe që kanë fokus të veçantë në këtë dimension janë:

- Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji 57/2019 Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë.
- VKM nr. 658, datë 17.10.2005 'Për Standardet e Shërbimeve Shoqërore'.
- Vendim Nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

b. legjislacionin për personat me aftësi të kufizuara (PAK) ²

Kjo paketë e plotë legjislative gjendet në përmbledhjen zyrtare nga Qendra e Botimeve Zyrtare, ndër të cilat jepen edhe instrumentet ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuara. Lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuar, specifiku i referohemi:

1 Shih bazën ligjore të përmbledhur në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror <https://www.sherbimisocial.gov.al/institucione-perkujdesi/legjislacioni/>

2 Shih botimin përmbledhës të Qendrës së Botimeve Zyrtare për personat me aftësi të kufizuara <https://uogj.edu.al/upload/Evidenacat%20shqip%202021/dok%20Juridike/Permbledhese%20legjislacioni%20per%20personat%20me%20aftesi%20te%20kufizuar%202020.pdf>

- Ligj-nr-93-dt-24.7.2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"

- Udhëzim i përbashkët i MMSR dhe MSH nr. 21, datë 7.10.2016 'Për miratimin e kriterëve për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuara të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot'
- Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuara e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre"
- Vendim Nr. 822, datë 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore"
- Udhëzim Nr. 597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara"
- Linku Paketa_ligjore__per_sherbimet_e_kujdesit_shoqeror.pdf (adrf.al)

Në aktet e tjera legjislative të prezantuara në këtë përmbledhje, zbatojmë dhe fokusohemi te pjesa specifike ku aftësia e kufizuara lidhet me fëmijët. Në përgjithësi, ndjekim parimin se rregullat e përgjithshme që legjislacioni adreson për personat me aftësi të kufizuara aplikohen edhe për fëmijët (për sa të jetë e mundur dhe e arsyeshme). Në ato raste ku dispozitat referojnë konkretisht për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafet do të implementojnë këto parashikime gjatë punës me fëmijët.

c. legjislacionin e fëmijëve, duke evidentuar parimet dhe parashikimet e tjera ligjore për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës, veçanërisht kur këta fëmijë janë me aftësi të kufizuara³

- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
- Kodi i Familjes
- Ligji i ri 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"
- VKM Nr. 54, dt. 31.01.2018 "Për Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen"
- VKM Nr. 91, dt. 14.02.2018 "Për Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"
- VKM Nr.148, datë 13.03.2018 "Për Përcaktimin e Rregullave të Bashkëpunimit ndërmjet Mekanizmave Këshillimorë e Koordinues Institucionalë, Strukturave për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Organizatave Jofitimprurëse, për Realizimin e Politikave Kombëtare e Vendore si dhe për shërbimet e Nevojshme për Mbrojtjen e Fëmijës"
- VKM nr. 353, dt.12.06.2018 "Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative"
- VKM nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes"
- VKM nr.565, datë 29.9.2018 "Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

³ Shih përmbledhjen e përditësuar nga publikim i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës <https://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-i-Punes-se-Agjencise-Shteterore-per-te-Drejtat-dhe-Mbrojtjen-e-Femijes-dhe-i-strukturave-te-mbrojtjes-se-femijeve-Viti-2017.pdf>

1.2 Burimet mbi aktet ligjore

Në rast se gjatë punës suaj duhet të konsultoni për efekt të procesit të menaxhimit të rasteve dhe aktivitetit me fëmijët me aftësi të kufizuara, ju duhet që të kërkonte në këto burime informacioni:

1. Në përmbledhjen e legjislacionit të institucioneve kryesore si: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.
2. Në dokumentin strategjik që institucione apo organizata ju referojnë zyrtarisht në momente të caktuara.
3. Në bibliografinë e ofruar në këtë Manual.
4. Në website zyrtar të Qendrës së Botimeve Zyrtare www.qbz.gov.al
5. Në rubrikën 'publikime' të disa prej organizatave që kanë eksperiencë shumëvjeçare si: Save the Children, Terre des Hommes, World Vision, ADRF etj.

Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se aktet normative me fuqi të përgjithshme në vendin tonë janë: Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, ligjet, aktet e pushtetit ekzekutiv, aktet e pushtetit vendor. Kjo hierarki e normave juridike, e modeluar për punën që stafet e shërbimeve sociale duhet të bëjnë për fëmijët me aftësi të kufizuara janë:

<i>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë</i>	Parimet e përgjithshme se fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë, objektivat sociale
<i>Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj</i>	Konventa e Kombeve të Bashkuara e të Drejtave të Fëmijëve, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
<i>Ligjet</i>	Kodi i Familjes, Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, Ligji për rininë, Ligji për shërbimet sociale
<i>Aktet e pushtetit ekzekutiv</i>	VKM për përcaktimin e tipologjisë të personave/fëmijëve me aftësi të kufizuara, Manual i Ministrisë për tipologjinë e aftësive të kufizuara të fëmijët
<i>Aktet e pushtetit vendor</i>	Në përgjithësi urdhërat e Kryetarit të Bashkisë apo vendime të Këshillit Bashkiak, planet e buxhetit për përkrahjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Një përmbledhje më e detajuar sipas hierarkisë ligjore gjendet më poshtë:

KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

LIGJ Nr.9669, datë 18.12.2006 "PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE"

LIGJ NR.10 329, datë 30.9.2010 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006 "PËR MASAT NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE", TË NDRYSHUAR

LIGJ Nr. 125/2020 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006, "PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE", TË NDRYSHUAR

LIGJ Nr.10 347, datë 4.11.2010 "PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS"

UDHËZIM Nr. 6, datë 21.5.2014 "PËR PROCEDURAT E SISTEMIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR, PUBLIKE DHE JOPUBLIKE"

UDHËZIM Nr. 10, datë 25.2.2015 "PËR MËNYRAT, FORMAT E BASHKËPUNIMIT DHE PROCEDURAT E NDËRHYRJES NË NDIHMË TË FËMIJËVE NË RREZIK PËR INSTITUCIONET DHE STRUKTURAT KRYESORE PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS"

UDHËZIM Nr. 14, datë 10.5.2016 "PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË EMERGJENCËS NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR TË FINANCUARA NGA FONDET E BUXHETIT TË SHTETIT PUBLIK QË OFROJNË SHËRBIME TË PËRKUJDESIT REZIDENCIAL PËR FËMIJËT NË NEVOJË"

UDHËZIM Nr.830, datë 14.4.2008 "PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR, PËR FËMIJËT NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE

LIGJ Nr. 121/2016 "PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

LIGJ Nr.8153, datë 31.10.1996 "PËR STATUSIN E JETIMIT"

Miratimi i Standardeve për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës.

VKM Nr.233, datë 10. 4.1998 PËR ZBATIMIN E LIGJIT "PËR STATUSIN E JETIMIT"

VENDIM NR 864, DATË 24.12.2019 "PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT POLITIK KOMBËTAR PËR MOSHIMIN, 2020-2024, DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E TIJ."

VENDIM Nr. 670, datë 10.11.2021 PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1140, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA 2021–2025 DHE PLANIN E VEPRIMIT 2021–2022"

Strategjia kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030

Plani kombëtar për personat me aftësi të kufizuara 2021-2025

Vendim nr. 658, datë 17.10.2005 për standardet e shërbimeve shoqërore

VENDIM Nr.752, datë 8.9.2010 PËR MIRATIMIN E "STANDARDEVE TË SHËRBIMIT TË KUJDESTARISË PËR FËMIJËT NË NEVOJË"

VENDIM Nr. 572, datë 24.6.2015 PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE NË QENDRËN KOMBËTARE TRANSITORE TË EMERGJENCËS

UDHËZIM NR.911, DATË 27.12.2018 "PËR MIRATIMIN E STANDARTET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR NË QENDRAT KOMUNITARE SHUMËDISIPLINORE"

UDHËZIM NR.394, DATË 09.05.2019 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT MULTIDISIPLINAR, SI DHE PROCEDURAT DHE ZBATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMIT TË PËRKUJDESJES ALTERNATIVE PËR FËMIJË NË FAMILJE KUJDESTARE"

URDHËR NR.101, DATË 21.02.2020 "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT (PSV) PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE NGA PUNONJËSET/PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT SI ANËTARË TË MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT (MKR)"

Vendim nr.822, datë 6.12.2006, për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore

Vendim Nr.821, datë 6.12.2006 Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”

Vendim Nr.823, datë 6.12.2006, Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat ditore

Vendim nr.233, datë 10. 4.1998, për zbatimin e ligjit “Për statusin e jetimit”

Vendim Nr.659, datë 17.10.2005, Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale

Udhëzim nr. 631, datë 21.11.2022 për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët 6–15 vjeç

UDHËZIM Nr. 582, datë 18.12.2017 PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE, NË QENDRAT SHITËPI FAMILJE, PËR FËMIJËT 16–18 VJEÇ

Udhëzim nr.911, datë 27.12.2018, “ Për miratimin e standardeve e ofrimit, të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në qendrat komunitare shumëdisiplinore”

Udhëzim nr.581, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake për të moshuarit”

Udhëzim nr. 355, datë 2.6.2022 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të integruar lëvizës në familje, për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre dhe manuali i zbatimit”

Urdhër nr.254, datë 10.04.2020 “Për protokollin e funksionimit të qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat), për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit në situatën e pandemisë së Covid-2019”

Standardet e shërbimit të linjës kombëtare të këshillimit për viktimat e dhunës në familje

1.3 Disa dokumenta strategjikë (të tjerë) të rëndësishëm

Përtej ligjeve kryesore, edhe këto dokumenta janë fokus i rëndësishëm në punën tuaj:

1. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030
2. Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara (i miratuar me VKM nga 2021-2025 ⁴
3. Agjenda Kombetare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 2021 - 2026
4. Plani Lokal Social, specifik për cdo bashki

Në kategorinë e dokumentave të tjerë që vijnë si një studim i konsoliduar i shoqërisë civile apo organizatave ndërkombëtare mund të përmendim edhe: Aftësia e kufizuar te fëmijët në Shqipëri, prevalenca e aftësisë së kufizuar, aksesit të shërbimeve dhe cilësia e shërbimeve ⁵, botim i World Vision Shqipëri

Manual praktik për hartimin dhe zbatimin e Planit Edukativ Individual (PEI) 2017 për fëmijët me aftësi të kufizuara, botim i Save the Children Albania ⁶

4 Shih https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-_2021-2025_AL.pdf

5 https://www.wvi.org/sites/default/files/PV%20FINAL_ALB.pdf

6 Shih <https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Udhezues%20Praktik%20per%20Hartimin%20dhe%20Zbatimin%20e%20PEI.pdf>

1.4 Parimet e përgjithshme që udhëheqin punën e stafeve të shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara

Stafet e shërbimeve sociale do të ndjekin parimet e përgjithshme për personat me aftësi të kufizuara për atë sa mund të aplikohen dhe të jetë e mundur edhe te kategoria e fëmijëve me AK. Këto parime pozicionohen përgjithësisht në gjithë aktet e sipërpervendura. Stafet do duhen që në secilin rast të kuptojnë se puna me fëmijët me aftësi të kufizuara është më specifike dhe paraqet në të shumtën e rasteve elementë të rinj dhe ndryshe për t'u mbajtur në fokus dhe konsideratë. Parimet kryesore të cilat nuk duhet të mungojnë në mjediset e stafeve të shërbimeve sociale për këtë kategori janë:⁷

1. **Mbështetja dhe kujdesi individual:** Shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara nevojitet të jenë të përqendruara nga kujdesi me në qendër fëmijën dhe e konsiderojnë 'fëmijën si të tërë', në kontekstin e familjes, shkollës, miqve dhe komunitetit lokal.
2. **Shërbimet efektive:** Shërbimet efektive sigurojnë mekanizmat e duhur mbështetës për t'iu mundësuar fëmijëve me aftësi të kufizuara që të zhvillohen duke përmbushur sa më mirë nevojat e tyre.
3. **Shërbime të sigurta:** Shërbimet promovojnë sigurinë e fëmijëve përmes vlerësimit të rrezikut, të mësuarit nga ngjarjet negative dhe zbatimin e politikave dhe procedurave të hartuara për të mbrojtur fëmijët me aftësi të kufizuara. Fëmijët kanë nevojë për mbështetje për të mësuar se si të jenë të sigurt kur zhvillohen dhe përgatiten për moshën e rritur. Shërbimet duhet të njohin mjaft mirë veçoritë e aftësisë së kufizuar, t'i japin përparësi sigurisë dhe mbrojtjes së tyre dhe të punojnë me fëmijët dhe familjet e tyre për t'i dhënë përparësi mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve.
4. **Staf i përgjegjshëm:** Çdo anëtar i stafit luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e një kujdesi efektiv, të sigurt dhe mbështetës për fëmijët. Ofruesi i shërbimeve organizojnë dhe menaxhojnë stafin dhe sigurojnë që stafi të ketë aftësitë, përvojën dhe 10 kompetencat e kërkuara për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
5. **Përdorimi informacionit:** Informacioni cilësor dhe sistemet efektive të informacionit janë thelbësore për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për fëmijët. Informacioni cilësor, i saktë, i plotë, i lexueshëm, i përshtatshëm, i besueshëm, në kohë dhe i vlefshëm, është një burim i rëndësishëm për ofruesit e shërbimeve në planifikimin, menaxhimin, shpërndarjen dhe monitorimin e shërbimeve. Për të përdorur në mënyrë efektive burimet e shumta të informacionit në dispozicion, ofruesit e shërbimeve kanë sisteme informacioni, duke përfshirë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, për të siguruar mbledhjen dhe raportimin e informacionit cilësor brenda kontekstit të marrëveshjeve efektive për menaxhimin e informacionit.

Mbani parasysh se në çdo hap të punës suaj me fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të ketë në fokus jo vetëm 'kurimin' dhe 'menaxhimin' apo 'përmirësimin' e aftësisë së kufizuar, por mbi të gjitha të sigurohet përfshirja dhe përshtatja e fëmijëve me AK në komunitet së bashku me fëmijët e tjerë dhe personat e tjerë më gjerë.

⁷ Mbështetur në Udhëzuesin e Terre des Hommes dhe Save the Children dhe Ndhimni jetën Udhërrëfyes për menaxhimin e sjelljeve problematike të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe dokumentimi i tyre, Tiranë, 2017, https://helphelife.org/rc/doc/Udherrefyesh_per_menaxhimin_e_sjelljeve_problematike_te_femijeve_me_aftesi_te_kufizuar_dhe_dokumentimi_i_tyre_5083.pdf, fq.8-12

II. Instrumentet dhe procesi i diagnostifikimit

2.1. Koncepte të përgjithshme të instrumentave dhe procesit të diagnostifikimit

Procesi i diagnostifikimit i fëmijëve me aftësi të kufizuara është një proces i dinamik që përfshin një gamë të gjerë të instrumenteve dhe procedurave për të identifikuar nevojat dhe aftësitë e tyre të veçanta. Këto janë disa nga instrumentet dhe proceset që janë përdorur gjerësisht në diagnostifikimin e tyre:

1. **Vlerësimi i zhvillimit:** Kjo përfshin vlerësimin e zhvillimit motorik, kognitiv, social dhe emocional të fëmijës. Instrumente të tilla si lëvizjet e reja të lindjes (motorike), testet e inteligjencës (kognitive), dhe shkala e vlerësimit të sjelljes janë përdorur në këtë proces.
2. **Testet e shenjave dhe simptomave:** Përdoren për të identifikuar shenjat dhe simptomat e mundshme të problemeve të shëndetit mendor, emocional dhe fizik të fëmijëve. Këto përfshijnë anketa për prindërit dhe mësuesit, si dhe vlerësime klinike.
3. **Vlerësimi i funksionimit diferencial:** Ky vlerësim i përqendruar në të njëjtën fushë të aftësive si fëmijët e zakonshëm, por në kontekstin e aftësive të kufizuara. Kjo përfshin vlerësimin e aftësive të fëmijëve për të përfshirë dhe përdorur të njëjtin program shkollor dhe për të kryer detyrat e përditshme.
4. **Vlerësimi i aftësive adaptive:** Ky lloj vlerësimi evidenton aftësitë e fëmijëve për të funksionuar në mënyra të përshtatshme në mjedisin e tyre, përfshin aftësitë kognitive, komunikative, sociale dhe praktike.
5. **Vlerësimi i nevojave të shërbimeve:** Përdoret për të identifikuar nevojat e fëmijëve për shërbime të ndryshme, si fizioterapi, logopedi, dhe ndihma të tjera shkollore ose sociale.
6. **Vlerësimi i rrezikut dhe burimet:** Ky vlerësim identifikon rreziqet potenciale dhe burimet e mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Diagnostifikimi dhe procedurat përkatëse përtej terrenit kombëtar, janë ngritur në një standard ndërkombëtar dhe europian.

MOS HARRONI!

PËR HAPAT E DUHURA FOKUSOHUNI NË STANDARDET E OBSH (ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË SHËNDETËSISË), SI DHE TË DISA ORGANIZATAVE TË TJERA RELEVANTE, VKM PËR VLERËSIMIN BIO-PSIKOSOCIAL NË SHQIPËRI.

2.2 Instrumentat dhe hapat sipas OBSH (Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetësisë)

OBSH ka ndërtuar sistemin WHODAS 2.0, i cili është një instrument vlerësimi praktik dhe gjenerik që mund të masë shëndetin dhe aftësinë e kufizuar:

Fusha 1: Njohja – të kuptuarit dhe komunikimi

Fusha 2: Lëvizshmëria – lëvizja motorike

Fusha 3: Kujdesi për veten – kujdesi për higjienën e dikujt, veshjen, ngrënien dhe qendrimi vetëm

Fusha 4: Mirëkuptimi – bashkëveprim me njerëz të tjerë në komunitet

Fusha 5: Aktivitetet e jetës – përgjegjësitë shtëpiake, koha e lirë, puna dhe shkolla

Fusha 6: Pjesëmarrja – bashkimi në aktivitete komunitare, pjesëmarrja në shoqëri.

Për të gjashtë fushat, WHODAS 2.0 ofron një profil dhe një masë përmbledhëse të funksionimit dhe aftësisë së kufizuar që është e besueshme dhe e zbatueshme në të gjithë kulturat, në të gjithë botën, duke e rekomanduar aplikimin e skemës edhe në rastet e fëmijëve. Në mënyrë më specifike, ky standard bashkëshoqërohet me instrumentin ICF, i cili paraqet teknikalitete dhe metodologji më specifike sipas rasteve të ndryshme.⁸

International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF)
Last Update: Jul 15

Search
[Advanced Search]
Home
Foundation
Proposals
Info

- ▼ International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF)
- ▼ ICF Category
 - ▶ Body functions
 - ▶ Activities and participation
 - ▶ Environmental factors
 - ▶ Body structures
- ▼ ICF Qualifier
 - ▶ Barrier or facilitator
 - ▶ Capacity
 - ▶ Extent or magnitude of impairment
 - ▶ Performance
 - ▶ Nature of change in body structure

WHO-FIC Maintenance Platform

Welcome to the Maintenance Platform for the WHO Family of International Classifications (WHO-FIC)
This site contains work in progress versions of the Classifications

- ICD-11
- ICF
- ICHI

For the latest release of ICD-11 please see I [ICD-11 Browser](#)
You need to create an account for yourself if you wish to contribute to the classification by writing proposals or comments by following the link below [Register](#)
Please note that the accounts you've created before the release of the classification are still valid.

Caveats

- The audience for this site is the maintainers, contributors and translators of the classification
- The classification seen on this is not the released version of the classification. The content in this platform may change on an ongoing basis
- For the latest release of the ICD-11 please see ICD-11 Browser

Related Information

[ICD-11 Home Page](#)

For more information about how to use this site, please see the [User Guide](#)

For more questions, please contact icd@who.int

⁸ International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF) (who.int)

2.3. Aplikimi i diagnostifikimit në Shqipëri

Në Shqipëri, diagnostifikimi rregullohet si procedurë specifike përmes **VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 722, datë 11.11.2019 'PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL, DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË TYRE'**⁹.

Është e rëndësishme për punonjësit e shërbimeve sociale kur trajtojnë rastin, pasi përpos vlerësimit dhe punës së tyre specifike, gjithnjë duhet t'i referohen vendimit përkatës të marra sipas kritereve, indikatorëve dhe standardeve që përcaktohen në legjislacionin shqiptar. Stafet e shërbimeve sociale inkurajohen që të njihen specifikisht me vlerësimin bio-psikosocial, si dhe të asistojnë sa munden prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve me aftësi ndryshe.

1. APLIKIMI PËR VLERËSIM: Procesi i mbështetur në modelin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar përfshin vlerësimin mjekësor të aplikuesit nga mjeku i familjes dhe nga mjeku specialist/QKSHM-ja, një intervistë me aplikuesin në zyrën e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë të kufizuar me mjekë dhe punonjës socialë, verifikimin e informacionit të marrë dhe kontrollin vjetor mjekësor.

2. STANDARDIZIMI I INDIKATORËVE: Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar dhe i nivelit të kufizimeve funksionale bëhet në përputhje me *Klasifikimin Ndërkombëtar mbi Funkcionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin të Organizatës Botërore të Shëndetësisë*. Ky vlerësim përfshin faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët, në përputhje me manualin për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar për të rriturit dhe fëmijët, të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe për shëndetësinë.

3. STRUKTURAT/INSTITUCIONET E VLERËSIMIT: Administrimi i procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror**. Pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror krijohen **komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar**, të cilat funksionojnë në nivel rajonal, që përbëhen nga punonjës me kohë të plotë dhe kanë në përbërje, së paku, një mjek dhe një punonjës social për çdo komision, të trajnuar për modelin biopsikosocial të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara. Çdo komision asistohet nga një punonjës, i cili administron dhe regjistron të dhënat e aplikuesit. Komisionet kryesohen nga përgjegjësi i zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

4. DISPONIMI DHE MIRËMBAJTJA E TË DHËNAVE: Stafi i zyrës së vlerësimit kryen këto detyra:

- a) hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat e aplikuesit;
- b) vlerëson dhe shqyrton dosjet e paraqitura për vlerësim/rivlerësim;
- c) verifikon dhe shkëmben informacionin elektronik me rrjetin e institucioneve të tjera të kujdesit shëndetësor, të arsimit, punësimit e formimit profesional, të sigurimeve shoqërore, tatimeve, strukturave përgjegjëse pranë pushtetit vendor, si dhe institucioneve të tjera, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar dhe, kur nuk është e mundur, manualisht/zyrtarisht;
- d) ç) cakton datën e intervistës dhe njofton zyrtarisht kërkuesit, nëpërmjet administratorit shoqëror ose kthen zyrtarisht dosjen për plotësim, kur ka mungesë dokumentacioni, në njësinë administrative;
- e) organizon kryerjen e intervistës, sipas formatit 6, bashkëlidhur VKM përkatëse që përcakton metodologjin e vlerësimit bio - psikosocial, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit;

⁹ Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre (sherbimisocial.gov.al)

- f) dh) bën vlerësimin për përcaktimin e nevojës për ndihmës personal;
- g) përcakton nivelin e përgjithshëm të aftësisë së kufizuar;
- h) ë) bën përgatitjen e rekomandimeve për shërbime të tjera dhe marrjen e vendimit për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar;
- i) lëshon dokumentin që vërteton aftësinë e kufizuar, sipas formatit 7, bashkëlidhur VKM përkatëse që përcakton metodologjin e vlerësimit bio - psikosocial,;
- j) shqyrton të dhënat e kontroleve periodike të nevojshme, të kryera sipas formatit 8, bashkëlidhur VKM përkatëse që përcakton metodologjin e vlerësimit bio - psikosocial,
- a) gj) mban, ruan dhe përditëson të dhënat e dokumentacionit të kërkuesve e të përfituesve të aftësisë së kufizuar, elektronikisht dhe fizikisht;
- b) h) adreson fëmijët e moshës shkollore pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për vlerësimin e nevojave të tyre arsimore.

5. VENDIMI DHE EFEKTET: Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nxjerr vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e aftësisë së kufizuar, njofton zyrtarisht aplikuesin për vendimmarrjen dhe e pajis me dokumentin përkatës, që përcakton aftësinë e kufizuar. Vendimi për përfitimet e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmës personal i përcillet bashkisë, për:

- a) zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit;
- b) kryerjen e veprimeve financiare për dhënien e pagesës për përfituesit e aftësisë së kufizuar.

6. KONTROLLET E VAZHDUESHME: Administratori shoqëror pranë organeve të pushtetit vendor, lidhur me menaxhimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara, ka përgjegjësi për:

- a) hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit;
- b) kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individi, jo më pak se një herë në tre muaj;
- c) informimin e zyrës së vlerësimit për ndryshimin e gjendjes së personit me aftësi të kufizuara;
- d) informimin e individëve për shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë/njësisë administrative, në territorin e së cilës është banor individi;
- e) informimin e individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për vlerësim/rivlerësim të aftësisë së kufizuar;
- f) informimin e familjarëve për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore;
- g) informimin e familjarëve për të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar;
- h) monitorimin dhe mbështetjen e shërbimit të asistencës personale;
- i) evidentimin, raportimin dhe referimin e rasteve të abuzimit e të neglizhencës;
- j) evidentimin dhe verifikimin e rasteve të personave që përfitojnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, informimin e strukturave përgjegjëse të shërbimit social shtetëror për të kryer verifikimet me institucione të tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre, kur ka dijeni;
- k) ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj, me përjashtim të personave e të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë

përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë;

- l) ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj, si dhe të rasteve të përfituesve, të cilët ndodhen jashtë shtetit shqiptar për qëllime kurimi apo rehabilitimi;
- m) informimin dhe udhëzimin në komunitetet lidhur me skemën e aftësisë së kufizuar, me anë të fushatave të ndryshme informuese;
- n) bashkëpunimin me punonjësit socialë, që janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në nenin 36, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- o) adresimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të arsimit e formimit profesional dhe të punësimit, me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore, në përputhje edhe me rekomandimet e komisionit.
- p) monitorimi i punës së zyrave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, në bazë të metodologjisë së kontrollit të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe shëndetësinë.

Në varësi të vendimit dhe vlerësimit përkatës, llojet e 'aftësive ndryshe'¹⁰:

- a. paaftësia intelektuale
- b. çrregullimet e komunikimit: gjuhësore, të të folurit, komunikimit social, mbajtjes së gojës, të paspecifikuara të komunikimit
- c. spektri i autizmit
- d. inhibimit
- e. ADHD (hiperaktivitet, nivel i lehtë, i moderuar, i rëndë)
- f. ADD (çrregullimi i vëmendjes)
- g. HD (hiperaktivitet)
- h. çrregullime specifike të të nxënit: disleksi, në shkrim, në matematikë
- i. motore: lëvizjet stereotipe
- j. neurozhvillimore të paspecifikuara.

¹⁰ Një pjesë e mirë e akteve ligjore shqiptare vijojnë të përdorin terminologjinë 'aftësi të kufizuara'.

E rëndësishme për punonjësit e shërbimeve sociale:

1. Respektoni dhe kushtojini vëmendje 'çdo gërmë' në vendimin e vlerësimit të aftësisë të kufizuar.
2. Adresoni mendimet tuaja për vlerësimin specifik të fëmijës me të cilin ju punoni
3. Ngrini planet individuale dhe ato të terapisë në grup për fëmijët me aftësi të kufizuar.
4. Mbani të informuar prindërit, kujdestarët, punonjësit e shërbimeve sociale sidomos në nivel bashkie, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat ndërkombëtare.
5. Fokusohuni edhe te treguesit e përmirësimeve, jo vetëm te ekzistenca e problematikave me fëmijët që ju punoni.

III. Llojet e shërbimeve

3.1 Parimet e ofrimit të shërbimeve

Stafet e shërbimeve shoqërore rolin më thelbësor, adresojnë në ofrimin e shërbimeve për të mundësuar jetesën e integruar të fëmijëve me aftësi ndryshe në komunitet dhe shoqëri. Edhe pse shërbimet mbeten të individualizuara sipas çdo rasti, ka disa parime, standardizime dhe kërkesa ligjore të cilat duhen respektuar për efekt të funksionimit sa më eficient të gjithë procesit. Ofrimi i shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara kërkon një qasje të kujdesshme dhe të specializuar për të siguruar që nevojat e tyre të adresohen në mënyrë efektive. Disa prej parimeve të rëndësishme për ofrimin e këtyre shërbimeve përfshijnë:

1. **Përmbajtja dhe shërbimet e individualizuara:** Çdo fëmijë me aftësi të kufizuara është unik dhe ka nevoja të veçanta. Është e rëndësishme të përshtaten shërbimet për t'i adresuar nevojat e tyre individuale.
2. **Përfshirja:** Mundësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshihen në mjediset e tyre natyrore, si shkolla, lojëra dhe aktivitete shoqërore, është thelbësore për zhvillimin e tyre social dhe emocional.
3. **Përqendrimi në aftësitë:** Fokusimi në aftësitë dhe potencialet e fëmijëve, në vend të përqendrimit tek kufizimet, është një qasje e rëndësishme për të ndihmuar ata të zhvillojnë vetëbesimin dhe vetëdijen pozitive.
4. **Bashkëpunimi me prindërit dhe familjen:** Prindërit dhe familjet kanë një rol të rëndësishëm në përkrahjen e zhvillimit të fëmijëve të tyre. Bashkëpunimi dhe komunikimi i hapur me ta është thelbësor për të siguruar mbështetje të përhershme dhe koordinim në ofrimin e shërbimeve.
5. **Përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve të asistuara:** Teknologjia dhe mjete të ndryshme të asistuara mund të jenë shumë efektive në përmirësimin e qasjes dhe përkrahjen e aftësive të fëmijëve me kufizime.
6. **Trajnim dhe zhvillim profesional:** Personeli që punon me fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të ketë trajnim të specializuar dhe të vazhdueshëm për të zhvilluar aftësitë dhe njohuritë e tyre në këtë fushë.

Për t'u informuar dhe kërkuar detajet e nevojshme për të ofruar shërbimet e duhura ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, mund të konsultoni vazhdimisht:

- a. Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, duke përfshirë edhe fëmijët si target grup specifik
- b. Ligji për shërbimet shoqërore
- c. Ligji për fëmijët dhe mbrojtjen e tyre
- d. Metodologjitë, teknikalitetet dhe njohuritë praktike të fushave të shkencave psiko-sociale dhe relevante me to.

3.2 Disa aspekte/sfida specifike të Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara ¹¹

- Sigurimin e lehtësirave në institucionet shëndetësore për vizitat e personave me aftësi të kufizuara.
- Trajnimin e infermierëve dhe dentistëve në shkolla dhe zgjerimin e përshtimeve të punës së tyre për të shërbyer në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, në zonat ku ato punojnë.
- Hartimin e paketës bazë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe trajnimin e personelit që do ta përdorë atë.
- Informimin e prindërve mbi shërbimet shëndetësore, si dhe mbi lloje të ndryshme sëmundjesh që shkaktojnë aftësi të kufizuara.
- Plotësimin e kuadrit ligjor për të mundësuar ofrimin e pajisjeve të teknologjisë ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara dhe rritjen e kapaciteteve për njohjen, vlerësimin dhe aplikimin e saj në përputhje me nevojat e personit me aftësi të kufizuara.
- Ngritjen e qendrave kombëtare dhe/ose lokale të rehabilitimit.
- Rritjen e kapaciteteve të ndihmës personal rreth kujdesit shëndetësor të personave me aftësi të kufizuara.
- Dehospitalizimi i pacientëve kronikë pranë spitaleve psikiatrike.
- Përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore "mjekim i detyruar".

3.3 Llojet e shërbimeve

Shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara janë të rëndësishme për të siguruar që ata të kenë qasje të barabartë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie si dhe për të ndihmuar ata të zhvillojnë potencialet e tyre të plotë. Disa nga llojet e shërbimeve që mund të ofrohen për këtë grup të fëmijëve përfshijnë:

1. **Arsimimi i përgjithshëm dhe i personalizuar:** Programet arsimore duhet të jenë të përshtatura për nevojat e individëve me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin mësimin e shumë llojeve të aftësive, duke përdorur metoda të ndryshme mësimore dhe materiale të përshtatura.

11 https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-_2021-2025_AL.pdf

2. **Terapia dhe rehabilitimi:** Shërbime terapeutike si fizioterapia, terapia okupacionale, terapia gjuhësore janë të rëndësishme për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara të zhvillojnë aftësitë motorike, gjuhësore dhe të tjera.
3. **Ndihma dhe mbështetja shoqërore:** Programet që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje shoqërore mund të përfshijnë trajnime për prindërit, asistencë për të integruar fëmijët në shoqëri dhe ndihmë për të menaxhuar sfidat e përditshme.
4. **Aftësimi dhe përgatitja për punë:** Përfshirja në programe që ofrojnë aftësim dhe përgatitje për punë për fëmijët me aftësi të kufizuara është e rëndësishme për të siguruar që ata të kenë mundësi për një karrierë të suksesshme dhe për të qenë të pavarur në të ardhmen.
5. **Mbështetje mjekësore:** Sigurimi i aksesit në kujdes mjekësor dhe mbështetje mjekësore të specializuara për nevojat e tyre të veçanta është jetik për të siguruar mirëqenie dhe shëndet të mirë për fëmijët me aftësi të kufizuara.
6. **Programet shtëpiake dhe komunitare:** Programet shtëpiake dhe komunitare ofrojnë një mënyrë për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara në mjedisin e tyre të njohur, duke integruar ndihmën dhe mbështetjen nga familja dhe komuniteti.

Lloji i shërbimit	Si funksionon
Kujdestaria afatgjatë	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara mund të hyjnë në shërbimin e kujdestarisë afatgjatë nëpërmjet sistemit të mbrojtjes së fëmijës ose në rast se për ta nuk mund të kujdeset askush në shtëpi. ➤ Ata duhet të kenë një larmi mundësish për të nxitur marrëdhëniet, për të marrë pjesë në komunitet, si brenda shërbimit edhe në shoqëri. ➤ Për fëmijët dhe të rriturit që përdorin shërbimet duhet të bëhet i mundur angazhimi i tyre në aktivitete që përmirësojnë jetën, përfshirë ato që kanë një nivel të lartë rreziku. Kjo kërkon, ndër të tjera, që ata të mbështeten nga punonjës me të cilët mund të komunikojnë lehtësisht; që respektojnë individualitetin, dinjitetin dhe privatësinë e tyre, dhe që janë të ndjeshëm ndaj aspiratave dhe nevojave të tyre. ➤ Punonjësit e shërbimeve rezidenciale duhet të jenë të informuar për nevojat e veçanta sociale dhe zhvillimore të të rriturve dhe fëmijëve, dhe kërkesat e tyre të ndryshme që ata kanë kur rriten, zhvillohen dhe kalojnë nga fëmijëria në moshë madhore. Për të fuqizuar dhe mundësuar të rriturit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara të vënë në zbatim këto të drejta, shërbimet duhet të përdorin një qasje që ka në qendër individin, e cila mbështet ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes me cilësi të lartë, të sigurtë dhe efikase për personat me aftësi të kufizuara. Kjo qasje duhet të përfshijë leadership të mirë, punonjës të kualifikuar dhe me përvojë, dhe administrim efikas të burimeve.

<p>Kujdestaria e përkohshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kujdestaria e përkohshme ofron një pushim shumë të nevojshëm dhe mbështetje për familjet që kujdesen për një fëmijë ose të rritur me një aftësi të kufizuar të caktuar. ➤ Në shtete të ndryshme, programi ofron një minimum netësh të kujdestarisë së përkohshme për secilin muaj në shtëpinë e fëmijës. Kjo u jep prindërve një mundësi për të rimarrë energjitë dhe ofron një mundësi shumë të mirë për një fëmijë me aftësi të kufizuar për të pasur përvoja jashtë familjes së tyre. ➤ Në shumë shtete, ka udhëzime që janë të dobishme për kujdestarinë e përkohshme (të njohura edhe si pushime afatshkurtra). Në të thuhet se kujdestaria e përkohshme 'duhet të ofrohet në kontekstin e një pakete të kujdesit për familjet, dhe rekomandon që autoritetet të sigurojnë kujdes afatshkurtër më fleksibël, duke ofruar: <ul style="list-style-type: none"> - Kujdes cilësor për fëmijën të cilit prindërit i besojnë dhe që kërkon që fëmija të trajtohet së pari si fëmijë dhe më pas për çdo aftësi të kufizuar që mund të kërkojë ofrim të veçantë; - Disponueshmëri të planifikuar me prindërit që zgjedhin karakteristikat e përdorimit dhe të qenit i aftë për të përdorur një shërbim me fleksibilitet; - Një shërbim që përmbush nevojat e të gjithë fëmijëve. Mungesa e kujdestarisë së përkohshme për fëmijët me nevoja të ndërlikuara ka ngjallur shqetësim; - Kujdes që është në përputhje me formimin dhe kulturën e familjes së fëmijës, origjinën racore, bindjen fetare dhe gjuhën; - Kujdes i përshtatshëm për moshën, në mënyrë që fëmijëve të vegjël dhe adoleshentëve t'u jepet kujdesi dhe profesioni përkatës; dhe - Një program i integruar i mbështetjes së familjes që e shikon kujdestarinë e përkohshme të planifikuar si pjesë një larmie më të gjerë të shërbimeve të mbështetjes profesionale për të përmbushur nevojat e familjes. ➤ Një shërbim vendor: <ul style="list-style-type: none"> - Kujdes cilësor për fëmijën të cilit prindërit i besojnë dhe që kërkon që fëmija të trajtohet së pari si fëmijë dhe më pas për çdo aftësi të kufizuar që mund të kërkojë ofrim të veçantë; - Disponueshmëri të planifikuar me prindërit që zgjedhin karakteristikat e përdorimit dhe të qenit i aftë për të përdorur një shërbim me fleksibilitet; - Një shërbim që përmbush nevojat e të gjithë fëmijëve. Mungesa e kujdestarisë së përkohshme për fëmijët me nevoja të ndërlikuara ka ngjallur shqetësim; - Kujdes që është në përputhje me formimin dhe kulturën e familjes së fëmijës, origjinën racore, bindjen fetare dhe gjuhën; - Kujdes i përshtatshëm për moshën, në mënyrë që fëmijëve të vegjël dhe adoleshentëve t'u jepet kujdesi dhe profesioni përkatës; dhe - Një program i integruar i mbështetjes së familjes që e shikon kujdestarinë e përkohshme të planifikuar si pjesë një larmie më të gjerë të shërbimeve të mbështetjes profesionale për të përmbushur nevojat e familjes.
<p>Rehabilitimi me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara</p>	<p>Një shifër e lartë e fëmijëve me aftësi të kufizuara vazhdojnë të vendosen në kujdesin institucional.</p> <p>Modeli i rehabilitimit me bazë komunitare (RBK) është zhvilluar për të penguar institucionalizimin duke ofruar mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre në një sërë mjedisesh.</p> <p>Për fëmijët me aftësi të kufizuara është adoptuar qasja RBK, e cila përbëhet nga shërbime të drejtpërdrejta, advokaci dhe përfshirje sociale.</p>

**Shërbime shtëpiake
(shërbime me bazë
shtëpinë)**

Të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara, dhe detyra e Autoriteteve Vendore për të ofruar këto shërbime përfshin fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara. Detyra është të ofrojë të gjitha elementet e mëposhtme për të përmbushur nevojat e një personi me aftësi të kufizuar:

- Ndhimë në shtëpi që mund të përfshijë ndihmën në familje (një person që ofron ndihmë praktike me gjëra të tilla si gatimi, pastrimi e kështu me radhë);
- Ndhimë për sigurimin e një lidhjeje interneti, një televizori, shërbime biblioteke ose lehtësira të ngjashme argëtuese;
- Leksione, lojëra, shëtitje, ose lehtësira të tjera argëtuese jashtë shtëpisë ose ndihmë për përdorimin e lehtësirave arsimore në zonë;
- Lehtësira për udhëtime nga dhe drejt shtëpisë për të marrë pjesë në shërbimet e ofruara për personat me aftësi të kufizuara në komunitet;
- Ndhimë për përshtatjen e shtëpisë ose për ofrimin e lehtësirave të tjera shtesë për ta bërë shtëpinë më të sigurt, më të rehatshme dhe për ta bërë jetesën më të thjeshtë;
- Ndhimë për të shkuar me pushime nëse një gjë e tillë ofrohet sipas marrëveshjeve të bëra nga Autoriteti Vendor ose nga një autoritet tjetër;
- Ofrimi i vakteve në shtëpi ose diku tjetër.

Shërbimet direkte	<p>Përfshijnë ofrimin e kujdesit shëndetësor parandalues dhe kirurgjisë korigjuese për të ulur numrin e përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe trajnimin e prindërve për të ndihmuar në rehabilitimin e fëmijëve të tyre, përfshirë asistencën e ofruar për prindërit për të komunikuar me fëmijët që kanë dëmtime të dëgjimit duke u mësuar atyre gjuhën e shenjave.</p> <p>Ushtrimi i advokacisë ka përfshirë: punën për të integruar fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e përgjithshme ose ofrimin e aksesit në shkollat e veçanta, rritjen e ndërgjegjësimit për të pakësuar stigmatizimin kundrejt atyre me aftësi të kufizuara dhe përmirësimin e kuptueshmërisë së aftësive të kufizuara në familje; dhe advokimin për ndryshime legjislative për të ofruar bursa për fëmijët me aftësi të kufizuara, si edhe për të krijuar një sistem kartash identiteti për rastet me aftësi të kufizuara për lehtësimin e përfitimit të ndihmave financiare.</p>
Puna për përfshirjen sociale	<p>Ka përfshirë ndihmën për të siguruar se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë akses në klubet e fëmijëve në shkolla dhe për të promovuar mundësitë e punësimit duke ofruar trajnim profesional për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe trajnim, mikrofinancim dhe ndihmë për punësimin e prindërve.</p>
Qendrat rezidenciale	<p>Shërbime të kujdesit rezidencial janë shërbime të kujdesit njëzet e katër orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike.</p> <p>Në një qendër rezidenciale nuk mund të ofrohet shërbim për dy grupe në nevojë. Në rastin e shërbimit për fëmijët, ato janë të ndara edhe me grupmoshë, (0-6 vjeç, 6 – 15 vjeç dhe 15 – 18 vjeç). Gjithashtu, ndarje moshore ka edhe për shërbimet rezidenciale për PAK, (deri në 25 vjeç dhe mbi 25 vjeç)</p>
Qendrat ditore	<p>Qendrat e zhvillimit që ofrojnë shërbime ditore dhe rezidenciale hartojnë një deklaratë për shërbimet që ofrohen për këtë kategori sociale, që është deklarata e qëllimit. Në këtë deklaratë pasqyrohet në mënyrë të detajuar modeli i shërbimeve, kërkesat strukturore të ambjenteve ku do të ofrohen shërbimet, kërkesat organizative e funksionale të qendrës, kërkesat për plotësimin e nevojave për numrin dhe cilësinë e personelit që do të angazhohet për ofrimin e shërbimeve për personat me AK.</p>

Planet edukative individuale (PEI)

Këto janë udhëzime të qarta mbi të gjithë hapat e nevojshëm në hartimin e një PEI. Si ndërtohet PEI dhe si bashkëpunojnë të gjithë personat përgjegjës në këtë proces. Plani edukativ individual është një dokument i shkruar i përgatitur për një nxënës i cili specifikon qëllimet mësimore që duhet të arrihen nga nxënësi gjatë një periudhe të caktuar kohore, si dhe strategjitë e mësimdhënies, burimet dhe ndihmën e nevojshme për të arritur këto qëllime.

Edhe pse shihet si mjet a produkt, plani edukativ individual është më shumë një proces, e është cilësia e këtij procesi të hartimit të tij që përcakton cilësinë dhe efektivitetin e planit. Ai ndërtohet falë bashkëpunimit mes shkollës, prindërve, nxënësit (kur është e mundur) dhe shërbimeve, agjencive dhe profesionistëve të tjerë jashtë shkollës. Plani thekson aspektet e programit mësimor të nevojshme për përshtatje dhe modifikim e fokusohet në nevojat më parësore mësimore të nxënësit, edhe pse ai mund të ketë edhe nevoja të tjera në të nxënë që nuk do të marrin kaq prioritet në planifikim dhe monitorim.

Në të përshkruhen hapat që merren për të ndihmuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, që vijnë si rezultat i aftësive të kufizuara që kanë fëmijët e i ndihmon ata në mënyrë të posaçme të arrijnë objektivat akademike dhe shoqërore. Në plan nuk modifikohen të gjitha aspektet e kurrikulës apo nevojave të tjera në jetën e shkollës, por vetëm ato fusha të nevojave të identifikuara si të para, nga vlerësimi i fëmijës. Përshtatja dhe ndihma e dhënë do të jetë në varësi të nevojave mësimore të çdo nxënësi. Jo çdo nxënës me aftësi të kufizuara mund të ketë nevojë për një plan të tillë. Ndërsa të tjerë mund të kenë nevojë për modifikime të ndjeshme mësimore.

IV. Strukturat bashkëpunuese për ofrimin e shërbimeve shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara

Strukturat bashkëpunuese që funksionojnë dhe kanë lidhje me ofrimin e shërbimeve shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara në vendin tonë i përkasin një skeme dinamike. Në rast se subjektet e interesuara si: prindërit, fëmijët, punonjësit, të angazhuarit në organizata apo dhe të tjerë mund t'i drejtohen një prej strukturave të mëposhtme sipas rolit dhe funksionit që kryejnë.

Pushteti legjislativ: Kuvendi, si 'prodhuesi' i ligjeve përbën ombrellën kryesore të përcaktimeve ligjore bazike duke ngritur kështu parimet, të drejtat, standardet e trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Si një punonjës i shërbimeve sociale ju mund të konsultoni vazhdimisht pranë zyrave të Kuvendit apo edhe në faqen zyrtare informacione të ligjeve, ndryshimeve, projektligjeve apo aktiviteteve që lidhen me trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Në mënyrë specifike, trajtimi i kësaj kategorie është fokus i veçantë i **Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë**.

Pushteti ekzekutiv: Pushteti ekzekutiv luan një rol të dyfishtë për fëmijët me aftësi të kufizuar, duke 'patur në duar':

- propozimin e ligjeve të reja apo ndryshimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke gëzuar iniciativën legjislative sipas Kushtetutës.
- implementon, vendos në zbatim dimensionet e kërkuara ligjore (psh një VKM është një akt ligjor i cili nxirret në bazë të ligjit dhe implementon në detaje kërkesat ligjore).

Këshilli i Ministrave është struktura gjithpërfshirëse që bën të mundur zbatimin dhe krijimin e politikave për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në faqen e Kryeministrit në mund të gjejnë informacionin gjithpërfshirës të ministrave aktuale dhe kontakteve relevante. Kështu, secila **ministri** mund të ketë lidhje direkte apo indirekte sipas funksionit të tyre për një aspekt referuar fëmijëve me aftësi të kufizuara (psh. Ministria e Transportit për të krijuar disa facilitete infrastrukturore për fëmijët me aftësi të kufizuara).

Në mënyrë specifike, Ministria që ka kompetencë ekskluzive është **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**. Ministria është organi që menaxhon funksionimin e strukturave të shërbimeve shoqërore, edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ministria realizon aktiviteteve të herëpashershme për fëmijët me aftësi të kufizuara, takime me aktorët relevantë që punojnë në këtë fushë, si dhe japin informacion të përditësuar ligjor. Sipas strukturës aktuale, **Spektori për Zhvillimin e Politikave për Personat me Aftësi të Kufizuara** përgjigjet specifikisht lidhur me ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Jo më pak të rëndësishme, duke u ndodhur edhe më pranë komuniteteve përkatëse janë edhe institucionet e varësisë të cilat menaxhojnë politika të mëvetësishme dhe të detajuara për këtë dimension. Mund të përmendim:

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve: struktura e këtij informacioni ka vendosur në agjendën e aktiviteteve edhe mbrojtjen apo përmirësimin e shërbimeve ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Shërbimi Social Shtetëror: Shërbimi Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionin e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin për :

- 28 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Drejtori Rajonale,
- Administrata Qendrore e Shërbimit Social Shtetëror si edhe,
- 61 njësi të qeverisjes vendore.

Këtë mision e realizon nëpërmjet:

- Administrimit të Shërbimeve Shoqërore për individët në nivel kombëtar;
- Programimit dhe detajimit të fondeve të ndihmës ekonomike;
- Programimit dhe detajimit të fondeve të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- Programimit dhe detajimit të fondeve për shërbimet shoqërore;
- Kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe përdorimit të fondeve buxhetore për ndihmën; ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e shoqërore;
- Administrimit të **Regjistrit Elektronik Kombëtar** për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror;
- Monitorimit të standardeve të shërbimeve sociale në nivel kombëtar.

Mbulon shpenzimet për financimin e:

- Familjeve të skemës së Ndihmës Ekonomike;
- Kompensimit të pagesave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Shërbimit në institucionet e kujdesit social;
- Shpenzimeve administrative për Administratën Qendrore;
- Shpenzimeve administrative për Drejtoritë Rajonale;
- Shpenzimeve për investime.

Financohet nga:

- Kontributet e buxhetit të shtetit;
- Kontributet e pakta nga donacione e sponsorizime.

ALOKIMI I FONDEVE BUXHETORE

Institucionet për të cilat alokohen fondet:

- Institucionet e përkujdesit;
- Drejtoritë Rajonale;

- Administrata e Shërbimit Social Shtetëror;
- Njësitë administrative për Ndihmë Ekonomike dhe PAK.

TREGUESIT PËR DETAJIMIN E FONDEVE

Institucionet e përkujdesit

- Numri i përfituesve të vendosur në institucionet rezidenciale;
- Numri i përfituesve të vendosur në institucione ditore;
- Numri i përfituesve që përfitojnë kuotë vetjake;
- Ditët e qëndrimit në institucion për rezidencialët 365 ditë dhe ditorët 269 ditë;
- Masa e kuotës ushqimore dhe vetjake.

Drejtoritë Rajonale

- Numri i kontrolleve për të gjitha njësitë vendore;
- Numri i kontrolleve dy herë, për njësitë më problematike;
- Përdorimin e drejtë të fondeve të akorduara në cash;
- Shpenzime për udhëtime dhe dieta;
- Shërbime të tjera si energji elektrike, shërbime postare e telefonike.

Administrata e Shërbimit Social Shtetëror

- Numri i kontrolleve për 12 Drejtoritë Rajonale, 29 Institucionet e Përkujdesit si edhe disa nga njësitë vendore;
- Numri i kontrolleve dy herë, për njësitë më problematike;
- Shpenzime për udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit;
- Shërbime të tjera si energji elektrike, shërbime postare e telefonike;
- Karburant, siguri, kancelari etj.

Për Ndihmë Ekonomike

- Vlerësimin social-ekonomik të gjëndjes së familjes apo anëtarëve të saj;
- Struktura e familjeve dhe grupet përfituese sipas treguesve të njësive të pushtetit vendor;
- Masa plotë e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas strukturës për çdo familje përfituese dhe për çdo grup përfituesish;
- Masa e ndihmës ekonomike mujore të pjesshme, duke zbritur vlerësimin e të ardhurave;
- Fondet faktike të shpenzuara për çdo dy-mujor paraardhës, i cili ka shërbyer për planifikimin e dy-mujorit pasardhës.

Për PAK

- Personat e paaftë të lindur ose të bërë gjatë jetës;

- Personat e verbër;
- Paraetraplegjikët;
- Invalidët e punës;
- Shkallëzimin në % të kategorive përfituese;
- Kompensimet e energjisë dhe telefonisë fikse për kategoritë e të verbërve dhe paraetraplegjikeve;
- Masa e përfitimit për çdo kategori si dhe numri i personave me aftësi të kufizuara sipas të dhënave të ardhura nga njësitë vendore;
- Fondet faktike të shpenzuara për çdo dy-mujor paraardhës, të cilët kanë shërbyer për planifikimin e dy-mujorit pasardhës

Luajnë një rol thelbësor për vendimmarrje të caktuara për fëmijët me aftësi të kufizuara:

- **Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror** për lëshimin e dokumentacionit përkatës
- **Komisioni i Vlerësimit bio-psikosocial:** që përbëhet nga përgjegjësi i zyrës, një mjek dhe specialist (të paktën) të trajnuar sipas modelit bio-psikosocial dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar në legjislacionin dhe politikat tona.
- **Punonjës** që ofrojnë shërbime të specializuara si: psikolog, mjek, psikiatër, neurolog, logopedist, fizioterapist si dhe të tjera relevante në varësi të problematikës dhe aftësisë së vlerësuar nga Komisioni.

Pushteti gjyqësor: Gjykatat në vendin tonë (Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Administrative) mund të jenë strukturat që mund të konsiderohen për të kërkuar një të drejtë të mohuar, të shkelur, apo të pamëshuar si duhet nga ana e institucioneve të administratës publike referuar fëmijëve me aftësi të kufizuara. Edhe pse rekomandohet të shihet apo trajtohet si shkalla e fundit për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, sjellim në vëmendje kryesore se:

a. Në çdo rast gjykimi, rastet për fëmijët me aftësi të kufizuara shqyrtohen gjithnjë në praninë e punonjësve psikologë dhe staf mbështetës, duke siguruar për sa të jetë e mundur dhoma apo ambiente të mëvetëshme nga ambientet ku shqyrtohen çështjet për të rritur.

b. Gjykatat mund të cilësohen si një mundësi e mirë për të 'dënuar' sjelljet e paduhura apo standardin e ulët të stafeve të shërbimeve shoqërore lidhur me këtë aspekt, duke theksuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijës.

Pushteti vendor: Ligji nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore' u vesh strukturave të pushtetit vendor detyrën e krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Në këtë mënyrë, **bashkitë** apo **njësitë administrative** janë përgjegjëse për menaxhimin e rasteve individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në fushën e menaxhimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara bashkia, njësia administrative përkatëse dhe drejtoria përkatëse rajonale e shërbimit shoqëror kanë njëkohësisht detyrën e menaxhimit, përmirësimit dhe rritjes së standardeve të këtyre shërbimeve. Psh.

Qendrat Ditore janë struktura të përcaktuara me VKM dhe që financohen nga buxheti i shtetit (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe nga bashkia. Bashkia konsiderohet të luajë një rol decisiv sidomos në identifikimin e rasteve dhe përcjelljen e tyre në struktura të tjera me qëllim marrjen e ndihmës në mënyrë sa më eficiente dhe duke minimizuar aspektet e burokratizimit.

Institucione të pavarura: Ombudsmani (Avokati i Popullit), Komisioni për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit mbeten gjithashtu struktura me një rol të konsiderueshëm për analizën dhe identifikimin e situatës në vend për fëmijët me AK si dhe me respektimin e standardeve. Këto dy institucione në raportime periodike apo vjetore trajtojnë në një rubrikë të posaçme përmirësimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara në vendin tonë.

Media: Raste të ndryshme me efekt ndërgjegjësimit për rastet individuale apo edhe në përgjithësi të trajtimit të fenomenit në Shqipëri përmes mediave, shërbejnë për të nxitur reagimin e opinionit publik, por edhe të strukturave vendimmarrëse lidhur me këtë aspekt. Rekomandohet që publikimi i rasteve në media të respektojë maksimalisht dinjitetin dhe të dhënat personale, duke mos patur në fokus abuzimin, por përmirësimin e situatave.

Organizata ndërkombëtare apo të shoqërisë civile: Organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare, të cilat janë të shumta dhe operojnë prej disa vitesh në vendin tonë, kanë realizuar dhe po implementojnë projekte që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara. Misioni dhe vizioni i tyre bëhet punë mbështetëse për strukturat e shërbimeve shoqërore. Rekomandohet mbajtja dhe ndërtimi i kontakteve të vazhdueshme me këto organizata me qëllim fuqizimin dinamik të punës që duhet realizuar me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Biznese: Edhe pse në mënyrë indirekte, bizneset përmes fondeve të kujdesit social mund të bëhen mbështetës në komunitete të ndryshme lidhur me mbështetje infrastrukturore apo edhe sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mbajtja në fokus e këtyre strukturave do t'i shërbente menaxhimit sa më të suksesshëm të këtij dimension.

Strukturat në nivel lokal

Drejtoria e Shërbimeve Sociale në nivel bashkiak është një strukturë lokale, pjesë e Bashkisë Kavajë e cila drejton politikat sociale në nivel lokal dhe organizon ofrimin e shërbimeve sociale ndaj grupeve në nevojë, duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara. Drejtoria përbëhet nga dy sektorë: Sektori i pagesave të ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuara si dhe sektori i shërbimeve sociale.

Detyrat kryesore të Drejtorive të Shërbimeve Sociale janë ofrimi i shërbimeve për fëmijët dhe familjet e tyre. Gjithashtu, këto departamente ose sektorë janë përgjegjës për identifikimin e fëmijëve në nevojë në zonën e tyre dhe ofrimin e informacionit për shërbime; për mbajtjen e një regjistri për fëmijët me aftësi të kufizuara; për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara që minimizojnë efektin e aftësive të tyre të kufizuara dhe dhënien e mundësisë që ata të bëjnë një jetë sa më normale që të jetë e mundur; për ofrimin për fëmijët që jetojnë me familjet e tyre elementet e mëposhtme: Këshilla, udhëzime dhe këshillim; aktivitete profesionale, sociale, kulturore ose argëtuese; ndihmë në shtëpi (që mund të përfshijë pajisje larëse); lehtësira ose ndihmë për udhëtime nga shtëpia dhe për në shtëpi, për të përfituar nga shërbimet; asistencë për t'i mundësuar fëmijës dhe familjes së tij/saj të bëjnë një pushim. Plani i veprimit parashikon që drejtoria e shërbimit social në bashki të përmirësojë vlerësimin e aftësisë së kufizuara duke kaluar nga modeli mjekësor në modelin bio-psikosocial; ai parashikon gjithashtu ofrimin e shërbimeve sociale duke kombinuar ndihmën financiare në të holla me kujdesin social cilësor. Gjithashtu, për vazhdimin e sigurimit të përfitimeve në të holla është e nevojshme të ofrohet një larmi e madhe e shërbimeve komunitare dhe rezidenciale për të promovuar deinstitutionalizimin nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve me bazë komunitare.

Njësia e mbrojtjes së Fëmijëve – një strukturë e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Kavajë e cila ka për qëllim për të mbikëqyrur, koordinuar dhe vënë në zbatim ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës brenda bashkisë. Ato koordinojnë ekipet ndërdisiplinore për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, është përgjegjës dhe ka për detyrë:

- a) të mbështesë punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- b) të hedhë informacionin për fëmijët në nevojë për mbrojtje, masat e mbrojtjes dhe planet individuale të mbrojtjes në bazën e të dhënave përkatëse, të miratuar nga ministri përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në nivel bashkie dhe njësie administrative;
- c) të mbikëqyrë mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkive, për të cilin është marrë masë mbrojtjeje ose është hartuar Plan Individual Mbrojtjeje;
- d) t'i raportojë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësite administrative përkatëse;
- e) të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore;
- f) të koordinojë funksionimin e grupit ndërsektorial në nivel bashkie dhe/ose njësie administrative, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin e ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve për masat e mbrojtjes dhe të dhunës në familje;
- g) të ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/ komunës;
- h) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.

Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të rasteve është një komponent shumë i rëndësishëm i qeverisjes së mirë në nivel vendor. Qëllimi i saj është të identifikojë individët dhe familjet në nevojë, të vlerësojë nevojat dhe nivelin e riskut për këta individë, dhe të ofrojë informacion dhe këshillim mbi shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore. Njësia për

Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit ka një rol kyç në garantimin e barazisë dhe të drejtave të barabarta për grupet në nevojë dhe vulnerabël, duke përfshirë viktimat e dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuar, familjet me probleme sociale, familjet në varfëri, grupet e marginalizuara dhe të moshuarit me vështësi ekonomike ose shëndetësore. Projekti i ngritjes së kësaj njësie është një hap drejt krijimit të një infrastrukture të përshtatshme për sektorin social, duke përmirësuar shërbimet për komunitetin në nevojë. Për të realizuar funksionet e përcaktuara, njësia duhet të ketë punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6,000 deri në 10,000 banorë.

Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit – një strukturë lokale e cila duhet të ngrihet në çdo njësi administrative dhe që ka për qëllim:

- Vlerësimin e nevojave të komunitetit për shërbime sociale të orientuara drejt nevojave reale të komunitetit;
- Identifikimin e nevojave dhe mënyra se si shpërndahen shërbimet ekzistuese;
- Vlerësimin sistematik të programeve ekzistuese dhe planifikimet për përmirësimin e shërbimeve;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve rreth problemeve të komunitetit dhe efektet që këto probleme mund të kenë mbi komunitetin e tyre;
- Rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet rreth planifikimit të përbashkët komunitar.

Qendra Ditore “Ngjyrat e Jetës”

Kjo qendër ditore administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkinë Kavajë. Numri total i përfituesve në qendrën ditore është 17 fëmijë.

Kapacitetet e shërbimeve për qendrën ditore mbulojnë 25 – 30 FAK dhe numri i përdoruesve është më i vogël, 17 persona. Përqindja e përdorimit të shërbimit është 56%. Kjo tregon se shërbimet në sektorin publik nuk përdoren. Kjo mund të lidhet me llojin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara në sektorin publik, por duhen bërë kërkime të mëtejshme për të zbuluar arsyet e vërteta të këtyre fenomeneve.

V. MENAXHIMI I RASTIT

5.1 Koncepti i menaxhimit të rastit

Menaxhimi i Rastit është metodologji e cila siguron hap pas hapi ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për individët në nevojë (fëmijë, i rritur, apo familje) dhe që synon të promovojë dhe nxitë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqënien e personit. Menaxhimi i rastit në punën për mbrojtjen e fëmijëve mbështetet dhe drejtohet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, dhe mbështetet në nevojat e fëmijës, ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe në bashkëpunimin e ngushtë mes aktorëve të ndryshëm që kanë një ndikim në jetën e fëmijës përfshirë prindërit, mësuesit, psikologun, apo/ dhe personelin shëndetësor. Ky proces fillon me vlerësimin e rastit dhe vazhdon me analizën e informacionit dhe vlerësimin e nivelit të rrezikut.

Duke vazhduar më tej me planifikimin e shërbimeve për rastin, koordinimin e ofrimit të shërbimeve, monitorimin, dhe vlerësimin e impaktit dhe efektivitetit të shërbimit. Ky proces zakonisht drejtohet nga një punonjës social i trajnuar (ndryshe njihet dhe me emrin menaxher rasti), dhe shpesh herë në bashkëpunim me mësues, psikolog, mjek, polic, si dhe specialistë të trajnuar dhe kualifikuar në çështjet e fëmijëve. Duhet theksuar se menaxheri i rastit është i trajnuar në mënyrë specifike për këtë qëllim dhe merret specifikisht me zbatimin e metodologjisë për menaxhimin e rastit. Ndërkohë, që një punonjës social mund ta ketë fokusin e punës dhe më gjerë, përveçse në menaxhimin e rastit. Punonjësi social nga njëra anë, ka fokus dhe qëllim kryesor punën me rastin, nga ana tjetër është përgjegjës edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, ku një kujdes i posaqëm i kushtohet ndërgjegjësimit, informimit, dhe advokimit për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në territorin gjeografik që mbulon.

Modeli i Menaxhimit të Rastit në shërbimet për Mbrojtjen e Fëmijëve

Artikulli 3 (1) i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve thekson se në të gjitha veprimet që ndërmerren nga institucionet publike dhe ato private, gjykatat, autoritetet administrative ose nga struktura legjislativë, duhet të marrin në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës. Ka një dallim të qartë në konceptin e fëmijës si grup demografik dhe të fëmijës si individ, dhe ku në të dyja rastet secili grup ka burimet, nevojat, rrjetin e vet mbështetës, dhe vulnerabilitetin individual - ndërkohë që veprimet që duhet të ndërmerren duhet të jenë të tilla që të ndikojnë pozitivisht tek secili prej grupeve pavarësisht përcaktimit, dhe ku konsiderata e parë duhet të ketë në vëmendje fëmijën si individ me nevoja specifike. Një qasje e mirë dhe funksionale për menaxhimin e rastit duhet të sigurojë që objektivat dhe qëllimet e vendosura për planin për mbrojtjen e fëmijës janë arritur me profesionalitet dhe në mënyrë sistematike si dhe që kjo qasje ka patur në qendër fëmijën. Fëmija është aktivizuar përgjatë procesit për të mbrojtur veten dhe ky aspekt ka rëndësi njëkohësisht për të ndërtuar më tej reziliencën (rezistencën) dhe rikuperimin e fëmijës nga trauma e abuzimit.

Pse është i rëndësishëm modeli i Menaxhimit të Rastit?

- Siguron që cdo fëmijë t'i ofrohet një nivel shërbimi dhe mbrojtje me standarte dhe në interesin më të lartë të tij/saj;
- Adreson kompleksitetin e çështjeve të mbrojtjes dhe mirëqënies së fëmijës;
- Siguron përfshirjen e të gjithë aktorëve përgjegjës;
- Mund të lehtësojë ndërlikimet që sjell rasti dhe problematikat e caktuara duke promovuar bashkëpunimin;
- E vendos fëmijën në qendër (si nevojat dhe të drejtat e tij/saj); dhe
- Siguron vazhdimësi të procesit të ndihmës edhe pas daljes nga rreziku.

Nëpërmjet ndjekjes me korrektësi të hapave mundësohet që çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje t'i ofrohet i njëjti nivel dhe cilësi shërbimesh mbrojtjeje dhe përkujdesi duke marrë në konsideratë parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Aplikimi i të gjitha hapave në menaxhimin e rastit ofron një kornizë të qartë me veprimet që duhet të ndërmerren si vlerësimi, hartimi i planit individual, koordinimi, dhe monitorimi i zbatimit të planit. Në procesin e menaxhimit të rastit për punonjësin social, në qendër të procesit është fëmija. Procesi përfshin edhe familjen, por nuk duhet harruar se cdo hap në procesin zinxhir duhet të sigurojë që fëmija është në qendër të cdo veprimi si dhe faktin që nevojat dhe kapacitetet e fëmijës janë unik dhe duhen marrë në konsideratë "rast pas rastit". Në cdo hap që punonjësi social hedh, kërkon dhe synon t'i përgjigjet "hap pas hapi" pyetjeve si:

- *Cilat janë rreziqet serioze që mund të çenojnë sigurinë e fëmijës?*
- *Cfarë mund të arrihet në "interesin më të lartë" të fëmijës?*
- *Në cfarë niveli mund të përfshihet fëmija?*
- *Cilat janë mënyrat më të mira dhe jo dëmtuese që mund të përfshihet fëmija në proces?*
- *Me kë duhet të konsultohem?*
- *A kam mjaftueshëm informacion që të ngre hipoteza dhe arrij në konkluzione?*
- *Cfarë vendimesh mund të merren dhe pse?*
- *Cfarë burime mund të përdoren për të ndihmuar fëmijën? dhe/ose*
- *Si do ta kuptoj që fëmija nuk është në rrezik?*

Qëllimi i menaxhimit të rastit është që të ofrojë një sistem transparent koordinimi, monitorimi, dhe kontrolli i cili lehtëson një proces që nxit ndërmarrjen e veprimeve për promovimin e mbrojtjes së fëmijëve. Ky sistem mbështetet shumë fort në qasjen e punës në ekip të cilët punojnë së bashku për të marrë dhe menaxhuar vendime me qendër fëmijën.

Parimet Bazë të Menaxhimit të Rastit

Parimet kryesore që duhen patur parasysh gjatë menaxhimit të rastit (Bowles, 2009).

- Respekti për personin – detyrimi për të respektuar mendimet, dëshirat, shqetësimet dhe opinionet e personit.
- Ofrimi i shërbimeve që përmirësojnë mirëqenien dhe minimizojnë rrezikun.
- Drejtësia dhe Barazia - detyrimi për të qënë i drejtë në shpërndarjen e përfitimeve dhe vlerësimin e rrezikut.
- Shmangia ose minimizimi i dëmtimit - detyrimi për të mënjanuar lëndimin e të tjerëve të përfshirë në proces.

5.2 Procesi i menaxhimit të rastit

Procesi i Menaxhimit të Rastit shpreh në mënyrë të detajuar hapat që duhet të ndërmerren pas identifikimit të një rasti në mënyrë që të sigurohemi që fëmija merr shërbimet dhe mbështetjen e duhur. Të gjithë rastet ndjekin të njëjtat hapa bazë, megjithëse detajet do të jenë të ndryshme gjatë çdo faze.

Procesi i menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm:

1. Identifikimin
2. Raportimin
3. Vlerësimin fillestar
4. Vlerësimin e plotë
5. Hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes
6. Zbatimin, ndjekjen dhe monitorimin e PIM-it
7. Mbylljen e rastit.

5.2.1 Identifikimi

Identifikimi i një fëmijë në nevojë për mbrojtje bëhet nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, mësuesit, ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor, strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Azilin dhe Antitrafikimin, Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuesit, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, si dhe vetë fëmijët.

NJMF-të dhe PMF-të kanë për detyrë të kryejnë identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet planifikimit të punës në terren, verifikimit të njoftimit të marrë nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijën, si dhe verifikimit të informacionit për rastet që vijnë në dijeni nëpërmjet medias së shkruar, elektronike apo medias sociale. (Formulari i identifikimit proaktiv).

Për të siguruar që fëmijët vulnerabël identifikohen në mënyrën e duhur, është e nevojshme që të rrisim ndërgjegjësimin e komunitetit përreth si dhe personave të tjerë, duke përfshirë dhe PMF kështu që ata mund të koordinojnë dhe bëjnë referime të mira.

Disa nevoja që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, të cilat mund të jenë tabu në një komunitet të caktuar, ose të cilat nuk konsiderohen abuzive, mund të referohen vetëm nëse komuniteti është i ndërgjegjshëm. Mund të ndodhë gjithashtu që nëse ju jeni e vetmja agjensi që adresoni këtë lloj të vecantë të mbrojtjes,

rritja e ndërgjegjësimit mbi këtë ceshtje mund të vendosë agjensinë në rrezik; vlerësoni riskun përpara se të vendosni nëse duhet dhe se si të ndani informacionin mbi ceshtjet për të cilat po punoni.

Fëmijët gjithashtu mund të angazhohen në identifikim dhe referim, pasi shpesh fëmijët që janë në risk kanë shumë të ngjarë të ndajnë problemin e tyre me fëmijë të tjerë. Nëse ju mbështesni këtë lloj qasje duhet të siguroheni që fëmija i cili bën identifikimin apo referimin e një rasti të një fëmijë tjetër duhet që të sigurohet mbështetja për këtë fëmijë gjithashtu.

Për disa fëmijë është shumë e vështirë që të kërkojnë ndihmë. Ndonjëherë kjo është e lidhur me kontekstin në të cilin abuzimi ka ndodhur, ose ajo mund të jetë për shkak të situatës aktuale në të cilën ndodhet fëmija. Në rastet e abuzimeve të qëndrueshme dhe serioze, fëmijët mund të kenë zhvilluar strategjitë e mbijetesës për të përshtatur sjelljen e tyre me qëllim reduktimin e rrezikut të abuzimit të mëtejshëm. Në raste të tilla, raportimi duhet përfshijë strategji relaksuese dhe përbaluese, të cilat mund të jenë të vështira për tu realizuar – që i kërkojnë fëmijës të pranojë që abuzimi po ndodh dhe të përballet me ndikimin që ka të bëjë me të, në familjen e tyre, veten e tyre, emocionet dhe mirëqenien.

5.2.2 Raportimi

Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.

Çdo mësues, ofruer i shërbimit psikosocial shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë njësisë arsimore vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e fëmijës.

Raportimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje bëhet me çdo mjet komunikimi, me telefon, e-mail, me postë, në formë shkresore, duke kontaktuar punonjësën e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës.

Profesionistët e përmendur më lart, ose struktura përgjegjëse pranë institucionit/ve raportojnë menjëherë, me çdo mjet komunikimi, rastet që identifikohen si në rrezik të menjëhershëm apo të lartë, ndërsa, rastet e tjera të rrezikut, të mesëm apo të ulët, raportohen brenda 24 orëve nga identifikimi. Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

Formulari i plotësuar dërgohet në mënyrë elektronike apo me postë te punonjësi/njësia përgjegjëse e mbrojtjes së fëmijëve. Në formular hidhet i gjithë informacioni dhe të gjitha detajet e ditura nga personi/personat, të cilët janë në dijeni dhe kanë raportuar rastin.

Rasti raportohet te PMF-ja përgjegjëse për territorin ku është bërë identifikimi. Në rast se është e pamundur të kontaktohen këto struktura, njoftohet Agjencia, e cila merr masa për ndjekjen e rastit nga ana e strukturave vendore të mbrojtjes.

Me marrjen e raportimit, NJMF-ja/PMF-ja ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat e veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin ose jo të vlerësimit fillestar të rastit. Procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës, sipas pikës 7, të nenit 67, të ligjit.

Disa referues mund të jenë të shqetësuar në lidhje me faktin që po referojnë një fëmijë në një autoritet të qeverisë lokale, kështu që është e rëndësishme për ti bërë ata të ndjehen mirë dhe të sigurtë. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të shpjegojë shkurtimisht, se kush është procesi për të ndjekur shqetësimin/problemin e paraqitur/referuar.

Nëse bëhet fjalë për më shumë se një fëmijë, atëherë një formë Identifikimi duhet të plotësohet për çdo fëmijë.

5.2.3. Procesi i vlerësimit, identifikimi i rrezikut

Gjatë vlerësimit duhet të kuptojmë mundësitë dhe aftësitë e të rriturit dhe kapacitetin për prindërim, për të përmbushur nevojat e fëmijës.

Vlerësimi është një proces:

- a. sistematik për mbledhjen e informacionit të detajuar në lidhje me fëmijën në rrezik ose në nevojë;
- b. për të identifikuar pikat e forta të fëmijës dhe familjes, mjedisin social në të cilin jeton fëmija dhe familja, si dhe nevojën e fëmijës për kujdes, mbështetje dhe mbrojtje alternative.

Vlerësim i plotë hedh bazat për Planin Individual për Mbrojtjen e Fëmijës. Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi ndryshon nga hetimi i cili mund të ndërmerret nga policia lidhur me ndjekjen penale të abuzuesit. Vlerësimi përqendrohet kryesisht mbi nevojat e fëmijës, të familjes dhe mbi sigurinë e tyre.

Brenda vlerësimit plotë, mund të ndërmerren edhe vlerësime specifike– p.sh. një vlerësim mjekësor i veçantë për të identifikuar një çështje shëndetësore ose një vlerësim mbi zhvillimin e fëmijës, i cili mund të ndërmerret nga një psikolog.

Përpara se të nisë vlerësimi i plotë është mirë që të organizohet një takim strategjik ndërmjet institucioneve apo organizatave të cilat kanë punuar me familjen apo kanë njohuri mbi familjen, në mënyrë që të planifikohet vlerësimi dhe të përcaktohen veprime kyçe lidhur me vlerësimin. Kjo është e rëndësishme sidomos kur rasti është kompleks ose kur që prej vlerësimit fillestar rezultojnë se fëmija ka nevojë për shërbime urgjente (p.sh. nëqoftëse një fëmijë është braktisur ata kanë nevojë për një vend të sigurt për të qëndruar). Edhe nëse janë ofruar shërbimet e emergjencës, është e rëndësishme që të ndërmerret një vlerësim i plotë pasi kjo do të sigurojë ofrimin e kujdesit të gjithanshëm për fëmijën.

Gjatë procesit të vlerësimit të plotë është mjaft e rëndësishme që të merret në konsideratë niveli i rrezikut në të cilin ndodhet fëmija. Në qoftë se kemi informacion që sugjeron se fëmija mund të jetë në rrezik të lartë ose të menjëhershëm, atëherë mund të nevojiten ndërhyrje të menjëhershme në mënyrë që të ofrohet siguria e fëmijës deri sa të përfundojë vlerësimi.

Fazat gjatë procesit të Vlerësimit

Të gjithë vlerësimet duhet të ndjekin të njëjtat faza:

Faza e Parë – Planifikimi i Vlerësimit.

Faza e Dytë – Mbledhja e Informacionit.

Faza e Tretë – Verifikimi i Informacionit.

Faza e Katërt – Analizimi i Informacionit (Dhënia kuptim e informacionit).

FAZA E PARË: PLANIFIKIMI I VLERËSIMIT – gjatë kësaj faze përcaktohet se cili është informacioni i nevojshëm, kush do ta mbledhë informacionin, ku dhe kur. Gjatë një rasti në rrezik të menjëhershëm, rrezik të lartë, ose kur situata është shumë komplekse, mund të jetë e nevojshme që të organizohet një takim i Pikave Fokale të Mbrojtjes së Fëmijëve të institucioneve dhe\ose organizatave të cilat kanë punuar

me familjen apo kanë njohuri mbi familjen, në mënyrë që të planifikohet vlerësimi dhe të përcaktohen veprime kyçe lidhur me vlerësimin. Kjo është e rëndësishme sidomos kur rasti është kompleks ose kur që prej vlerësimit fillestar rezulton se fëmija ka nevojë për shërbime urgjente (p.sh. në qoftë se një fëmijë është braktisur ata kanë nevojë për një vend të sigurt për të qëndruar). Edhe nëse janë ofruar shërbimet e emergjencës, është e rëndësishme që të ndërmerret një vlerësim i plotë pasi kjo do të sigurojë ofrimin e kujdesit të gjithanshëm për fëmijën.

FAZA E DYTË: MBLEDHJA E INFORMACIONIT – kjo fazë ka të bëjë me mbledhjen e të gjithë informacionit të duhur. Ka disa mënyra të ndryshme sesi mund të mblidhet informacioni:

- Kontrolli i informacionit të përfshirë në dosje, nga raportet e mëparshme.
- Intervista dhe takime me personat të cilët kanë punuar me familjen – si psh. mësues, mjekë ose OJF.
- Intervista me komunitetin ku gjendet fëmija apo familja.
- Intervista me anëtarët e familjes.
- Intervista me fëmijën.
- Vëzhgimet e marrëdhënieve familjare.
- Vizitat në familje/shtëpi (për të vëzhguar dhe vlerësuar mjedisin familjar të fëmijës).

Konfidencialiteti është shumë i rëndësishëm. Personat që organizojnë vlerësimin nuk duhet të nxjerrin informacionin ose ta përgojnë atë!

FAZA E TRETË – VERIFIKIMI I INFORMACIONIT – Shpeshherë kur ndërmerret një vlerësim mund të dëgjohen histori / informacione të ndryshme. Është e rëndësishme që ky informacion të verifikohet edhe përmes personave të tjerë për t'u siguruar që është i saktë. Për shembull, në qoftë se prindi thotë se fëmija sillet gjithmonë keq do të ishte e dobishme që informacioni të kontrollohej me shkollën dhe me anëtarët e tjerë të familjes për të parë nëse edhe ata ndajnë të njëjtin mendim.

FAZA E KATËRT – ANALIZIMI I INFORMACIONIT – Faza përfundimtare e vlerësimit është analizimi. Kjo ka të bëjë me vlerësimin e të gjithë informacionit në mënyrë që të përcaktohet situata e fëmijës dhe niveli i rrezikut në të cilin ndodhet fëmija, në mënyrë që të përcaktohen në mënyrën e duhur dhe nevojat e fëmijës. Ndonjëherë është e vështirë që të analizohet informacioni dhe në këtë rast ky hap mund të shtyhet për fazën tjetër, atë të hartimit të Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës.


Parimet që drejtojnë procesin e vlerësimit janë:

- **Të bazohet në zhvillimin e fëmijës** dhe të njohë rëndësinë e faktorit kohë në jetën e fëmijës. Specialistët duhet të jenë në dijeni të pasojave, ndryshimeve, dhe zhvillimit të fëmijës gjatë moshave të ndryshme. Koha është kritike, pasi fëmijët mund të mos përfitojnë atë për çfarë kanë nevojë në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre. Nëse profesionisti nuk ka siguri në vlerësimin e tij nëse një fëmijë po zhvillohet brenda parametrave të zakonshme të zhvillimit, atëherë duhet të kërkojë mendim më të specializuar për këtë çështje nga një doktor pediatër ose psikologë zhvillimi. Disa fëmijë mund të kenë nevojë shtesë ose specifike si vështirësi të të nxënimit; vështirësi për të mësuar; aftësi të kufizuara, ose nevoja specifike mjekësore.
- **Të ketë në qendër fëmijën** dhe të sigurohet që fëmija është gjithmonë në qendër të procesit të vlerësimit. Të gjitha veprimet, planet, dhe vendimet duhet të kenë në qendër fëmijën dhe marrjen në konsideratë të interesit më të lartë të fëmijës.

- **Të ketë qasje ekologjike** duke vendosur dhe konsideruar fëmijën brenda familjes dhe komunitetit të gjerë ku jeton. Ky parim kërkon që procesi i vlerësimit të konsiderojë me kujdes se çfarë ndikimi ka familja, mjedisi, shkolla, shokët, të afërmit në situatën e fëmijës. Gjithashtu, kjo qasje lejon punonjës social të identifikojë potencialet që ofron mjedisi dhe familja për fëmijën në situatën që ndodhet.
- **Përfshin punën aktive me fëmijën dhe familjen.** Puna e drejtpërdrejtë me fëmijën dhe familjen është kyc në rastet e fëmijëve në rrezik. Shumë kërkime kanë theksuar rëndësinë e partneritetit me prindërit për të ruajtur dhe kujdesur për fëmijën. Është e rëndësishme të krijohet një marrdhënie pozitive, që prindërit/kujdestarët të ndihen të respektuar dhe të informuar për procesin. Partneriteti duhet të bazohet në ndershmëri, transparencë, dhe respekt. Profesionistët duhet të luajnë rol thelbësor në respektimin e këtyre parimeve.
- **Të bazohet në fakte ose evidenca.** Proces i vlerësimit duhet të bazohet në fakte dhe evidenca objektive dhe profesionale, dhe nuk duhet të mbetet si gjykim subjektiv i punonjës apo profesionistëve të tjerë.
- **Mirënjeh dhe konsideron qasjen multidimensionale dhe ku punohet në partneritet me fëmijët dhe familjet e tyre.** Nevojat e fëmijës janë komplekse dhe si të tilla kërkojnë që të adresohen në mënyrë multi dimensionale, ku një fëmijë në nevojë për mbrojtje mund të ketë nevojë për kujdes shëndetësor, psikologjik, por dhe nevoja të caktuara të të mësuarit. Po ashtu, familja e fëmijës mund të jetojë në kushte varfërie apo mund të ketë persona me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojat e vecanta. Në këtë mënyrë, mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijës kushtëzohen nga një sërë nevojash komplekse që mund të përmbushen nga aktorë të ndryshëm. Qasja multidisiplinare kërkon bashkërendim, koordinim, dhe një punë të përbashkët mes shumë aktorëve për të përmbushur nevojat e fëmijës dhe familjes së tyre. Në të njëjtën kohë, ky parim duhet parë i lidhur ngushtë me partneritetin me fëmijën dhe familjen.
- **Është një proces i vazhdueshëm** dhe jo një moment i vecantë në procesin e ndihmës. Herë pas here vlerësohen nevojat e fëmijës dhe familjes nëse këto nevojat janë përmbushur, nëse nuk janë përmbushur, apo nëse nevojat ndryshojnë përgjatë një periudhe kohore. Edhe nëse fëmija dhe familja marrin ndihmën e parë të nevojshme dhe fëmija mund të konsiderohet se e ka kaluar rrezikun, është e rëndësishme që punonjësi social, të rivlerësojë nevojat dhe situatën ku ndodhet fëmija dhe familja.
- **Të sigurojë cilësi dhe mundësi të barabarta për të gjithë** duke qenë i ndjeshëm ndaj nevojave të ndryshme dhe rrethanave të fëmijës. Ky parim nuk nënkupton që të gjithë fëmijët të trajtohen njësoj në mënyrën sesi punohet, por lidhet me barazinë në procesin e vlerësimit dhe të ofrimit të shërbimeve për të gjithë rastet në nevojë për mbrojtje. Të qenit i ndjeshëm dhe i qëllimshëm ndaj nevojave specifike të fëmijut dhe familjes, është aspekt mjaft delikat dhe i rëndësishëm i punës së punonjës social në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Po ashtu, është po aq e rëndësishme që rrethanat dhe situata e fëmijës mund të ndryshojë dhe fëmijët me nevojat të caktuara për mbrojtje si dhe familjet e tyre kanë situata të vecanta dhe cdo rast duhet trajtuar si unik dhe i vecantë.

Dimensionet e Vlerësimit

Për të kuptuar një vlerësim të gjithanshëm duhet të merren në konsideratë një numër elementësh të cilët janë paraqitur në diagramin e mëposhtme:



Dimensionet gjatë Zhvillimit & Mirëqenies

Një element i rëndësishëm është mirëqenia e fëmijës. Për ta realizuar atë është e nevojshme që të merren në konsideratë nevojat e zhvillimit të fëmijëve pasi fëmijë të moshave të ndryshme kanë nevoja shumë të ndryshme. Kjo mund të arrihet duke marrë në konsideratë një numër dimensionesh të zhvillimit të fëmijës:

- **Mirëqenien Fizike dhe Mendore:** Kjo ka të bëjë me rritjen dhe zhvillimin si edhe me shëndetin fizik dhe mendor. Për t'u zhvilluar fizikisht dhe mendërisht ndër të tjera fëmijët kanë nevojë për një dietë të përshtatshme dhe të ushqyeshme, për një vend të përshtatshëm për të jetuar, vaksinime dhe kontrole të zhvillimit të tyre. Fëmijët më të rritur kanë nevojë për këshillime dhe informacione lidhur me çështjet shëndetësore, pirjen e duhanit, abuzimin e substancave, sjelljen seksuale dhe duhet të kenë akses ndaj shërbimeve të duhura shëndetësore.
- **Mirëqenia Emocionale dhe e Sjelljes:** Kjo ka të bëjë me ndjenjat dhe veprimet e fëmijëve dhe përfshin aftësinë e tyre për t'iu përshtatur ndryshimit, për të menaxhuar stresin, për të shfaqur vetë-kontrollin, dhe për t'u sjellë në mënyra të përgjegjshme sociale. Këto emocione dhe sjellje ndikohen nga natyra dhe cilësia e marrëdhënieve të hershme të fëmijëve me familjen dhe kujdestarët e tyre dhe me mbështetjen dhe udhëzimet që fëmijët marrin ndërkohë që rriten.
- **Kapaciteti Mendor:** Kjo ka të bëjë me zhvillimin njohës, arritjet arsimore dhe të mësuarit aktiv nga mjedisi i tyre. Zhvillimi i fëmijëve dhe rritja e kapaciteteve forcohen më tepër nga ofrimi i mundësive për shkollim, për të luajtur dhe për të ndërvepruar si me të rriturit ashtu edhe me fëmijët e tjerë, nëse ata kanë akses ndaj librave dhe simulimeve të tjera dhe nëse atyre u jepen mundësi për të fituar një numër aftësish. Ata të cilët shfaqin vështirësi në të mësuar mund të kenë nevojë për mbështetje të vazhdueshme në mënyrë që të siguroheni që ata do të arrijnë zhvillimin dhe potencialin e tyre maksimal.
- **Mirëqenia Morale dhe Shpirtërore:** Kjo ka të bëjë me ndjenjat, eksperiencat dhe besimin, të cilat stimulojnë ndjeshmërinë e fëmijës, rritjen e moralit dhe krijimin e ideve lidhur me kuptimin dhe natyrën e jetës dhe vdekjes. Për disa fëmijë kjo mund të mbështetet përmes traditave të besimit, të kulturës dhe përmes marrëdhënieve që kanë me familjen dhe anëtarët e komunitetit.
- **Identiteti:** Kjo ka të bëjë me vetë-besimin e fëmijës, me nivelin e respektit dhe vlerësimit si edhe të pranimit nga familja dhe nga shoqëria. Për të pasur një identitet të fortë pozitiv, fëmijët kanë nevojë që arritjet e tyre të vlerësohen dhe inkurajohen dhe që të marrin mesazhe pozitive për aspekte të ndryshme të identitetit.

- **Përkujdesja ndaj Vetes:** Kjo ka të bëjë me shprehjet dhe kompetencat për të cilat kanë nevojë fëmijët në mënyrë që të kujdesen dhe të respektojnë veten e tyre. Këto aftësi fillojnë të zhvillohen që në moshë të hershme psh. fëmijët e vegjël mund të mësojnë sesi të vishen dhe sesi të ushqehen vetë. Fëmijët më të rritur kanë nevojë për mundësi që të mësojnë për aftësitë e jetës të cilat mund t'i ndihmojnë ata për të promovuar zhvillimin e tyre dhe për t'i mbrojtur ata nga rreziqet.
- **Marrëdhëniet Familjare:** Pasja e një jete familjare të qëndrueshme ku ekziston ndjenja e përkatësisë, dhe ku ofrohet një prindërim i përshtatshëm dhe dashuri së bashku me mundësi për të hulumtuar dhe zhvilluar pavarësinë, ndihmon në zhvillimin pozitiv të fëmijës dhe në pasjen e marrëdhënieve të forta familjare. Nga ana tjetër këto marrëdhënie janë të rëndësishme për fëmijët pasi ndihmojnë në zhvillimin e dimensioneve të tjera, si p.sh. në lidhje me mirëqenien emocionale dhe identitetin e tyre. Që në moshë të hershme, por dhe më vonë ndërkohë që fëmijët rriten, ata gjithashtu fitojnë mundësi për të luajtur dhe për t'u socializuar me bashkëmoshatarët e tyre pasi kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë tek mënyra sesi fëmijët krijojnë lidhjet me botën e jashtme, dhe nga ana tjetër sesi ata ndihen për veten e tyre. Fëmijët gjithashtu mund të përfitojnë nga eksperiencat e tjera dhe nga aftësitë e të rriturve të cilët jetojnë në komunitetin e tyre.
- **Shfaqja Sociale:** Kjo ka të bëjë me të kuptuarit që fëmijët kanë për aftësitë e tyre si dhe me pranimin e ndikimeve që kanë veprimet e tyre, shfaqjen dhe sjelljen ndaj të tjerëve. Kur prindërit dhe të rriturit e tjerë shfaqin një interes ndaj fëmijëve, ata mësojnë se sjellja dhe pamja e jashtme mund të përshtaten në varësi të situatave të ndryshme dhe janë në gjendje të marrin vendime mbi mënyrën sesi ata duan të prezantohen. Kjo është një aftësi e rëndësishme zhvillimi për fëmijën në mënyrë që ata të mësojnë të përshtaten më mirë me mjedisin dhe komunitetin e tyre. Detyrat e prindërimit dhe përkujdesjes duhet t'i përshtaten kapaciteteve zhvillimore të fëmijës gjatë periudhës së rritjes, ndërsa zhvillohen dhe bëhen më të pavarur, dhe duhet të marrin në konsideratë karakteristikat individuale të fëmijëve.
- **Marrëdhëniet Shoqërore dhe me Bashkëmoshatarët:** Kjo lidhet me aftësinë e fëmijës për të pasur shokë dhe për t'u ndjerë pjesë e një grupi bashkëmoshatarësh dhe sesi ata lidhen me të rritur të tjerë të cilët nuk bëjnë pjesë në rrethin e tyre familjar. Që në moshë të hershme, por dhe më vonë ndërkohë që fëmijët rriten ata gjithashtu fitojnë mundësi për të luajtur dhe për t'u socializuar me bashkëmoshatarët e tyre pasi kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë tek mënyra sesi fëmijët krijojnë lidhjet me botën e jashtme, dhe nga ana tjetër sesi ata ndihen për veten e tyre. Fëmijët gjithashtu mund të përfitojnë nga eksperiencat e tjera dhe nga aftësitë e të rriturve të cilët jetojnë në komunitetin e tyre.

Një vlerësim siguron bazën për:

- identifikimin e nevojave dhe pikave të forta të fëmijës;
- identifikimin e kapaciteteve të prindërve apo kujdestarëve për të siguruar kujdesin e duhur për fëmijën;
- ndërtimin e një pamje tërësore ku fëmija dhe familja e tij/ saj përshtatet në komunitet; analizimin e gjendjes së fëmijës kur ka mbledhur të gjitha informatat;
- marrjen e vendimeve në lidhje me llojin e rrezikut që ekziston për një fëmijë dhe planifikimin e veprimeve që do të reduktojnë nivelin e rrezikut dhe përmirësimin e kapaciteteve dhe kujdesit që i ofrohet fëmijës.

Vlerësimi Fillestar

Vlerësimi fillestar është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut, bazuar në informacionin e disponueshëm nga identifikimi ose raportimi, si dhe nga informacioni që mund të merret nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën. Vlerësimi fillestar

kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit.

PMF-ja, gjatë vlerësimit fillestar, vlerëson:

- a) Nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër, duke mbajtur në konsideratë sigurinë, mbrojtjen fizike, shëndetin e fëmijës dhe nevojën për masë emergjente të mbrojtjes;
- b) Nevojat bazë, për sa u përket ushqimit, higjienës, strehimit dhe kujdesit shëndetësor;
- c) Shërbimet e domosdoshme, me qëllim përmbushjen e nevojave të identifikuar në kushtet e emergjencës.

Vlerësimi fillestar bëhet nga PMF-ja/NJMF-ja në territorin ku gjendet fëmija. Pas intervistimit fillestar të fëmijës apo verifikimit të gjendjes së tij, nëse fëmija nuk është në gjendje të flasë apo të intervistohet, të dhënat e marra nga PMF-ja dokumentohen menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 orë, në vlerësimin fillestar (Formulari i vlerësimit fillestar).

Nëse pas vlerësimit fillestar rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje, atëherë PMF-ja nuk hap dosje, por e referon atë pranë institucioneve përgjegjëse për ndjekje të situatës apo ofrimin e shërbimit të nevojshëm. PMF-ja mban një regjistër të posaçëm për veprimet e kryera për këto raste. Nëse pas vlerësimit fillestar PMF-ja konstaton ekzistencën e rrezikut edhe pasi i ka siguruar fëmijës shërbimet e nevojshme, për shkak të kushteve të emergjencës, ajo hap një dosje specifike (në letër dhe në format elektronik) për fëmijën.

Fëmijës i caktohet një numër, i cili do të jetë numri identifikues për të gjatë gjithë procesit të menaxhimit. Ky numër do të përdoret gjatë të gjitha komunikimeve, përveç rastit kur është e nevojshme të përdoret emri i fëmijës, për efekt të referimit apo ndërhyrjeve për mbrojtjen e tij.

Drejtuesi i NJMF-së cakton një nga PMF-të e kësaj njësie si menaxher rasti për secilin fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë përkatëse. Drejtuesi i NJMF-së, kur përcakton një PMF si menaxher rasti, merr parasysh ngarkesën e punës të secilës PMF dhe faktin nëse PMF-ja është përfshirë aktivisht në identifikimin apo kontaktin paraprak me fëmijën.

Në njësitë administrative ku ka vetëm një PMF, ajo shërben si menaxher rasti për të gjithë fëmijët në nevojë për mbrojtje. Në rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në nivel rreziku të lartë ose të menjëhershëm, PMF-ja e njësisë administrative, në menaxhimin e këtyre rasteve, do të mbështetet nga PMF-ja e bashkisë, i cila do të caktohet nga drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki.

Vlerësimi i Plotë

Vlerësimi i plotë kryhet për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes.

PMF-ja, gjatë vlerësimit të plotë, vlerëson:

- a) Nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, si dhe faktorët e rrezikut;
- b) Nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij/saj dhe nevojat e familjes;
- c) Faktorët mbrojtës, në veçanti pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e fëmijës, të familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë;
- d) Në rastet kur për fëmijën është marrë një masë emergjente mbrojtjeje, vlerësimi përfshin edhe

rezultatit e procesit të konfirmimit të masës nga gjykata, vlerësimin e kushteve të institucionit, të personit apo familjes kujdestare pranë të cilit është vendosur fëmija, në kuadër të masës.

Për realizimin e vlerësimit të plotë, PMF-ja duhet të kryejë, të paktën:

- a) Një vizitë në shtëpinë e fëmijës dhe të dhënat/informacionin e marrë gjatë vizitës i hedh në formularin për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime (formulari i vizitës në familje);
- b) Një intervistë me fëmijën, motrat/ vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, siç tregohet në formularin e intervistimit (formulari i intervistës).

Për realizimin e vizitave në familje, në rastet kur është e nevojshme për arsye sigurie apo kur prindi nuk është bashkëpunues dhe nuk lejon vizitën apo takimin e PMF-së me fëmijën/fëmijët e tjerë të familjes, PMF-ja kërkon që gjatë kryerjes së vizitës në familje të shoqërohet nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Pas mbledhjes së informacioneve për rastin, PMF-ja plotëson formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6). Vlerësimi i plotë kryhet brenda 20 ditëve pune nga vlerësimi fillestar. Gjatë kësaj periudhe PMFja ka detyrimin të mbledhë GTN-në, në rastet kur fëmija në nevojë për mbrojtje është në nivel rreziku të mesëm dhe të lartë. Në rastet e rrezikut të ulët, PMF-ja mbledh GTN-në vetëm nëse e vlerëson të nevojshme. Vlerësimi i plotë për rastet e rrezikut të menjëhershëm kryhet nga PMF-ja brenda 5 ditëve, nga miratimi i masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i sektorit të shërbimeve shoqërore në bashki. Vendimi për masën e mbrojtjes dhe vlerësimi i plotë i kalojnë për miratim gjykatës.

ANALIZA E RREZIKUT

Rreziku lidhet me mundësinë që një abuzim apo neglizhim të shfaqet ose rishfaqet në të ardhmen. Rreziku është mundësia që sjellja prindërore të jetë dëmtuese apo shkatërruese për zhvillimin mendor, fizik, emocional, dhe social të fëmijës dhe që personat që kanë përgjegjësinë prindërore e kanë të pamundur për t'u sjellë ndryshe me fëmijën.

Koncepti i sigurisë së fëmijës i referohet situatës kur një fëmijë nuk është i rrezikuar brenda familjes/ shtëpisë ose kur kapacitetet mbrojtëse brenda familjes mund ta manaxhojnë rrezikun për abuzim ose neglizhim. Rreziku është një term i përgjithshëm i cili i referohet “për të studiuar vendimet të cilat janë subjekt i pasojave të paparashikueshme” (Royal Society, 1992). Ky term përbëhet nga dy koncepte:

(1) Parashikimi i Rrezikut i cili përbëhet nga tre elementë: identifikimi dhe parashikimi i pasojave të mundshme, vlerësimi i rëndësisë së rrezikut, dhe llogaritja e probabilitetit që të ndodhë. Në punën për mbrojtjen e fëmijëve parashikimi i rrezikut do të thotë të llogaritësh gjasat që një fëmijë të abuzohet, si dhe të parashikosh sa i rëndë mund të jetë ky abuzim.

Vlerësimi i Rrezikut është procesi i përcaktimit të vlerës së pasojës së veprimit ose abuzimit. Jeta nuk na ofron një zgjedhje të vetme sic është të jetojmë të sigurt ose të rrezikuar. Cdo formë ose model jetese që zgjedhim ka aspektet pozitive dhe negative si dhe probabilitetet që këto aspekte të shfaqen. Profesionistët në fushën e mbrojtjes së fëmijëve e dinë që ata nuk kanë gjithmonë luksin që të bëjnë një zgjedhje të lehtë mes rastit kur duhet ta lënë fëmijën në një familje të rrezikshme dhe kur duhet ta zhvendosin ata nga kjo familje. Ka përfitime se përse fëmija duhet të qëndrojë në një mjedis të qetë dhe të stabilizuar; si dhe ka rreziqe kur fëmija dërgohet në një përkujdesje alternative ose rezidenciale.

Është e rëndësishme të përcaktohet niveli i rrezikut duke qenë se kuptimi i nivelit të rrezikut përbën elementin bazë për zhvillimin e një plani i cili do ta mbrojë fëmijën dhe do të provojë mirëqenien e tij.

Grupe të caktuara fëmijësh mund të quhen “vulnerabël” ose “në rrezik për abuzim”. Kur flitet për “nivele të rrezikut” kjo lidhet me nivelin e abuzimit që ka pësuar (apo mund të pësojë) fëmija dhe me rrezikun që ky abuzim do të dëmtojë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës. Vulnerabiliteti i referohet fëmijëve në nevojë, të cilëve nuk i plotësohen të gjitha nevojat, por që nuk janë në rrezik mbijetese. Gjithsesi në një perspektivë afatgjatë, vulnerabiliteti ndikon gjithashtu negativisht në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Ndërkohë që veprime si përdhunimi janë natyrisht raste të qarta abuzimi, ka edhe situata të tjera të cilat janë më të vështira për t'u vlerësuar. Për shembull, përkufizimi i saktë i termit abuzim psikologjik (emocional) është disi problematik pasi kërkon një vlerësim të kujdesshëm të vetë veprimit në lidhje me cilësinë dhe natyrën e marrëdhënies midis fëmijës dhe abuzuesit. Në këtë mënyrë një prej përcaktuesve kyç në përkufizimin e abuzimit është kuptimi që merr për fëmijën, pra pasoja në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë.

Për këtë arsye koncepti i kufirit është i dobishëm. Kjo do të thotë se një veprim (ose veprime) mund të konsiderohen si abuzuese kur ka pasur ose kur ka predispozitë të krijojë dëm të madh ndaj zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijës. Kjo kërkon një vlerësim të kujdesshëm të fëmijës, duke marrë në konsideratë nevojat e tij të zhvillimit.

Janë identifikuar katër nivele rreziku (ose kufij rreziku) – i ulët, i mesëm, i lartë dhe i menjëhershëm. Përcaktimi i nivelit të rrezikut kërkon vlerësim të kujdesshëm, megjithatë në mënyrë të përgjithshme, faktorët të cilët kanë tendencë të shfaqen në një nivel të caktuar rreziku, përfshijnë:

Tabela e mëposhtme ofron udhëzime të vlerësimit të nivelit të rrezikut.

Të gjitha rastet kur fëmija gjendet para një situatë kërcënuese për jetën, kur fëmija mund të dëmtohet apo gjymtohet rëndë, duhet të konsiderohen si Rrezik i Menjëhershëm.

Në varësi të ngarkesës së punës dhe numrit të rasteve të identifikuar, NJMF duhet t'i japë përparësi menaxhimit të rasteve të konsideruara "rrezik i menjëhershëm" dhe "rrezik i lartë".

Faktorët që ndikojnë	Rrezik i Ulët	Rrezik i Mesëm	Rrezik i Lartë
Mosha e fëmijës dhe kapaciteti mbrojtës	Fëmija është mbi 10 vjeç; fëmija nuk ka nevojë, ose ka shumë pak nevojë për përkujdesjen dhe mbështetjen e një të rrituri, në mënyrë që të mbrojë veten. Nuk ka paaftësi fizike ose zhvillimore.	Fëmija është 5-9 vjeç; në këtë moshë fëmija ka nevojë për ndihmën e një të rrituri në mënyrë që ta mbrojë osë të përkujdeset për atë; fëmijë introvers; sëmuret shpesh, problematika të mëdha të zhvillimit fizik dhe mendor; ka një paaftësi të lehtë ose të moderuar.	Fëmija është nën 5 vjeç; në këtë moshë fëmija varet tërësisht nga një i rritur për përkujdesje dhe mbrojtje; sëmuret shumë shpesh, problematika shumë të mëdha të zhvillimit fizik dhe mendor; Fëmijë me probleme sjelljeje shumë të mëdha.
Niveli i Abuzimit Seksual / Fizik	Nuk ka dëmtim ose ka dëmtim të lehtë; nuk është e nevojshme të merret trajtim mjekësor; nuk kanë ndikim të dukshëm mbi fëmijën; incident i izoluar	Plagosje e lehtë fizike ose të pashpjegueshme; ka nevojë për përkujdesje mjekësore ose diagnostikim; familja njihet për disiplinë të fortë, abuzim seksual pa kontakt	Ka nevojë të shkojë në spital ose të shtrohet në spital; familja njihet për disiplinë ekstreme ose mund të njihet për ngacmime seksuale

Pjesët e plagosura	Gjunjët, duart ose vithet	Busti	Koka, fytyra ose organet riprodhuese
Niveli i neglizhimit	Nuk kanë ndikim të dukshëm mbi fëmijën; incident i izoluar	Shqetësim që Prindi/ Kujdestari nuk mund të përmbushë nevojat bazë mjekësore, ushqyerjen, strehimin; me raste e lë fëmijën të pambikëqyrur	Prindi/Kujdestari nuk ka predispozitën që t'i ofrojë fëmijës kujdes mjekësor, ushqim ose strehim; shpeshherë fëmija lihet i pambikëqyrur
Histori të mëparshme mbi abuzimin / neglizhimin	Nuk ka histori abuzimi ose neglizhimi	Raportet e mëparshme shfaqin problematika; në të shkuarën është ofruar shërbim mbrojtjeje	I panjohur; raportet e mëparshme shprehen se ka pasur abuzim të madh ose të fortë
Mundësia që abuzuesi të kontaktojë fëmijën	Nuk ka – është larguar nga shtëpia / zona dhe nuk mund të kontaktojë fëmijën	Abuzuesi është akoma në shtëpi / zonën por ka një prind tjetër, apo të rritur i cili mund të mbrojë fëmijën dhe fëmija nuk lihet vetëm	Abuzuesi jeton në shtëpi dhe kontakton me fëmijën lehtësisht; nuk ka mundësi për të konfirmuar nëse të rritur të tjerë kanë mundësi të mbrojnë fëmijën
Aftësitë e prindërimit, kapaciteti emocional dhe fizik i Prindit/ Kujdestarit	Nuk ka dëmtim intelektual ose fizik; prishmëri të pranueshme për fëmijën; aftësi të plotë për të kontrolluar veten e tij / saj; emocionet / sjelljen; aftësi prindërimi të përshtatshme dhe njohin përgjegjësitë e tyre	Shfaq disa probleme të zhvillimit mendor, probleme shëndetësore, ka nevojë për planifikim dhe mbështetje për tu përkujdesur për fëmijën; cilësia e paqëndrueshme ose shumë e ulët e përkujdesjes; përdorimi i substancave (p.sh. drogë dhe alkool) zakonisht ndikojnë mbi aftësinë e prindërimit	Aftësi e kufizuar e rëndë / dëmtim njohës; mungesë e perceptimit real mbi realitetin; prishmëri ose perceptime jorealiste lidhur me sjelljen e fëmijës; aftësi prindërimi të ulët / ose mungon fare; abuzim me substanca të cilat shpeshherë ndikojnë mbi aftësinë e prindërimit
Disponueshmëria e kujdestarëve të tjerë	Dikush i cili është gati dhe në gjendje të marrë rolin e kujdestarit dhe i cili është në gjendje të ofrojë mbështetje dhe stabilitet	Dikush në familje mund të marrë përsipër rolin e kujdestarit kryesor por ata mbase nuk mund të jenë gjithmonë në shtëpi ose mund të përmbushin vetëm kërkesat bazë të përkujdesjes ndaj fëmijës ose ka nevojë për mbështetje shtesë	Nuk ka ndonjë të rritur të përshtatshëm për t'u kujdesur për fëmijën; i rrituri nuk ka dëshirë / mundësi ose mund të përbëjë rrezik për fëmijën

Sistemet e mbështetjes së familjes	Anëtarët e familjes, fqinjët ose miqtë premtajnë të ofrojnë mbështetje për fëmijën; familja është e përfshirë në aktivitete komunitare	Familja dhe fqinjët mund të ofrojnë mbështetje por kjo është e kufizuar	Nuk ka mbështetje familjare ose komunitare; familja dhe miqtë nuk kontribuojnë për problemin; familja jeton në zona të thella dhe janë të izoluar; familja nuk ka telefon ose mjete komunikimi
Mjedisi ku jeton familja	Shtëpia është e pastër dhe nuk ka / ka pak rreziqe sigurie ose shëndetësore	Ka mbeturina dhe materiale të tjera të papastra; nuk ka ujë / energji elektrike; ka milingona, buburreca etj.	Familja jeton në një zonë të thellë ose në një banesë të papërshtatshme
Stresi në familje / faktorë të tjerë rreziku	Familje, punë dhe të ardhura të qëndrueshme; marrëdhënie të ngushta me të afërmit	Shtatzëni ose fëmijë i porsalindur; nuk ka të ardhura ose ushqim të mjaftueshëm; familjes i mungojnë aftësitë për të menaxhuar çështjet familjare; ka konflikt në marrëdhënie me të afërmit	Bashkëshorti / bashkëshortja ka vdekur / është larguar ose ka pasur ndryshim në statusin martesor; konflikt martesor; dhunë në familje

Faktorët e rrezikut ndahen në katër grupe:

- Faktorët që lidhen me prindërit apo kujdestarët;
- Faktorët që lidhen me familjen;
- Faktorët që lidhen me fëmijën; dhe
- Faktorët që lidhen me mjedisin.

Faktorët që lidhen me prindërit apo kujdestarët

- Karakteristikat e personalitetit dhe mirqënia psikologjike;
- Historia e abuzimit;
- Abuzimi me substancat/shëndeti mendor;
- Qëndrimet dhe njohuritë;
- Moshë; dhe
- Të tjera (që mund të evidentohen nga pjesëmarrësit)

Faktorët që lidhen me familjen

- Struktura e familjes;

- Konfliktet bashkshortore dhe dhuna në familje;
- Stresi dhe ankthi; dhe
- Ndërveprimi prind-fëmijë

Faktorët që lidhen me fëmijën

- Moshë;
- Aftësia e kufizuar; dhe
- Karakteristika të tjera të fëmijës.

Faktorët që lidhen me mjedisin

- Varfëria dhe papunësia;
- Izolimi social dhe mbështetja sociale; dhe
- Komunitete të dhunshme;

Formulari i Vlerësimit dhe Analiza e Rrezikut

Ky formular duhet të përdoret për të regjistruar të gjithë informacionin e marrë përmes procesit të vlerësimit. Ai duhet të shpërndahet paraprakisht në Takimin e Grupit Teknik Multidisiplinar. Disa pjesë të formularit, si psh. nivelet e riskut, duhet të plotësohen në fund të takimit.

5.2.4. Planifikimi i Përkujdesit dhe i Mbrojtjes

Pas plotësimit të formularit të vlerësimit dhe analizës së rrezikut, PMF-ja harton Projektplanin Individual të Mbrojtjes, sipas formularit të PIM-it (aneksi nr. 7).

Projekt-plani Individual i Mbrojtjes hartohet mbi bazën e nevojave të identifikuara të rastit dhe përmban veprimet, ndërhyrjet dhe shërbimet e nevojshme për të ulur nivelin e rrezikut. PIM-i përmban:

- Listën e nevojave të fëmijës dhe familjes;
- Veprimet apo ndërhyrjet konkrete për aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijës;
- Shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat;
- ç) Vendimin për masën e mbrojtjes;
- Autoritetet dhe aktorët përgjegjës;
- Afatet kohore;
- Ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike.

PMF-ja ose drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki u dërgon anëtarëve të GTN-së formularin e PIM-it, projektin e PIM-it, formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut, së bashku me kërkesën për mbledhjen e GTN-së.

Në këtë mbledhje anëtarët e GTN-së:

- a) Finalizojnë vlerësimin e plotë, duke shqyrtuar e plotësuar, sipas rastit, informacionin e hedhur në formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6);
- b) Shqyrtojnë projektin e PIM-it dhe bëjnë rekomandimet përkatëse për ndërhyrjet apo shërbimet e nevojshme për rastin, duke caktuar detyrat për secilin anëtar të GTN-së, me afatet përkatëse, si dhe cilat shërbime apo ndërhyrje kanë nevojë të mbulohen me shpenzime nga ana e bashkisë.

Brenda dy ditëve pune nga mbledhja e GTN-së, PMF-ja reflekton në formularin e vlerësimit, analizën e rrezikut dhe në PIM ndryshimet, për të cilat bien dakord anëtarët e GTN-së.

PMF-ja i paraqet për miratim drejtorit të strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki PIM-in, së bashku me formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6) dhe rekomandimet e GTN-së.

Drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki, brenda dy ditëve pune, miraton PIM-in, bazuar në propozimin e bërë nga PMF-ja e GTN-ja dhe merr masat për prokurimin e shërbimeve, shpenzimet e të cilave rezultojnë të pambuluara në PIM-in e propozuar nga PMF-ja. Një kopje e PIM-it duhet të mbahet në dosjen individuale të fëmijës. Nëse drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki nuk e miraton PIM-in e propozuar, rasti i njoftohet Agjencisë, e cila merr masat e nevojshme, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Pas miratimit nga drejtori, PMF-ja ndan zyrtarisht, me të gjithë anëtarët e GTN-së, PIM-in përfundimtar.

Në rastin kur ka më shumë se një fëmijë në familje, hartohet një plan individual për secilin fëmijë, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre individuale. PMF-ja bën të gjitha përpjekjet për të siguruar bashkëpunimin e familjes e të fëmijës në realizimin e PIM-it dhe diskuton e u shpjegon fëmijës dhe anëtarëve të familjes përmbajtjen e PIM-it. Kur fëmija është mbi 14 vjeç, PMF-ja merr, në çdo rast, miratimin e fëmijës për masat e mbrojtjes të përfshira në PIM, kur kjo nuk prek interesin më të lartë të fëmijës. Punonjësit të tjerë të NJMF-së, NJVNR-së apo të ofruesve të shërbimeve shoqërore publike e private bashkëpunojnë dhe mbështesin PMF-në, nëse fëmija dhe/ose anëtarët e familjes së tij paraqesin vështirësi në të kuptuarin, shprehjen apo ndërveprimin e nevojshëm për zbatimin e PIM-it.

Formulari i shqyrtimit të progresit / planit individual të mbrojtjes së fëmijës duhet të përpilohet gjatë takimit përmes identifikimit të nevojave të fëmijës dhe mënyrave për t'i përmbushur ato. Aty gjithashtu do të përfshihen hapat që duhen ndërmarrë për të zvogëluar rrezikun. Kur hartohet plani është e rëndësishme të vlerësohen mirë alternativat e ndryshme pasi një përzgjedhje e cila mund të përmbushë një nevojë ose që mund të reduktojë një rrezik mund të ketë si pasojë shkaktimin e dëmit të mëtejshëm/krijimin e problemeve të reja.

Një kopje e Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës duhet të mbahet në dosjen individuale të fëmijës. Në rastin kur ka më shumë se një fëmijë në familje duhet të hartohet një plan individual për secilin fëmijë, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre individuale.

Fëmijët dhe anëtarët e familjes e dinë mjaft mirë cila është situata në familjen e tyre dhe çdo plan që mund të ndërmerret pa miratimin e tyre, mund të dështojë. Prandaj konsiderohet si një praktikë e mire që fëmija dhe prindërit/kujdestarët të jenë të pranishëm në Takimin për Mbrojtjen e Fëmijës në mënyrë që ata të marrin pjesë në procesin e planifikimit. Familjet dhe fëmijët mund të kenë nevojë për mbështetje dhe asistencë gjatë takimeve të tilla në mënyrë që ata të kenë mundësi të shprehin tërësisht mendimet e tyre.

Në rastet kur shqyrtohet zhvendosja e fëmijës nga familja, fillimisht duhet të vlerësohet strehimi tek anëtarët e tjerë të familjes, komunitetit dhe si alternative e fundit duhet të konsiderohet vendosja e tij në një strehëz apo institucion rezidencial. Në këtë rast, përpara se fëmija të kthehet në shtëpi, duhet të

ndërmerret një vlerësim për të gjykuar sesi është reduktuar rreziku në familje dhe a është e përshtatshme për fëmijën të kthehet në shtëpi.

Gjatë hartimit të Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijëve, duhet të merren parasysh gjithmonë pikat e mëposhtme:

- Interesi më i lartë i fëmijës;
- Respekti për fëmijën dhe anëtarëve familjaretë tij/saj;
- Fëmija dhe prindërit ose kujdestarët e tij / saj duhet të jenë të mirë-informuar dhe të marrin pjesë në vendimmarrje dhe llojet e ndërhyrjes dhe punën e rënë dakord;
- Konsultimi dhe bashkëpunimi me ofruesit e shërbimeve dhe profesionistëve të tjerë për të përmbushur të drejtat e fëmijës;
- Respektimi i vlerave kulturore dhe tradicionale të fëmijës dhe familjes së tij / saj, por jo nëse kjo e vendos fëmijën në rrezik;
- Rëndësia e mbajtjes së fëmijës në familje dhe sigurimi/ndërtimi i marrëdhënieve të mira;
- Shmangia e dublikimit të ndërhyrjes nga organizata të shumta për një familje.

Plani individual i mbrojtjes

Plani i ndërhyrjes dhe mbështetja për fëmijën dhe familjen e tij / saj do të zhvillohen duke marrë parasysh:

- a) moshën e fëmijës,
- b) fazën e zhvillimit,
- c) Nevojat e vlerësuara dhe format e mbrojtjes së fëmijëve për të cilat ai/ajo ka nevojë,
- d) burimet në dispozicion brenda komunitetit dhe vendndodhjen e fëmijës dhe nëse specifikisht e nevojshme shërbimet e disponueshme në shkallë kombëtare.

Plani individual për Mbrojtjen e Fëmijëve do të mbulojë një maksimum prej tre muajsh dhe do të rishikohet në një datë të caktuar të vendosur në takimin e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Takimi për rishikim e Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijëve mund të bëhen më përpara nëse:

- a. Gjendja e fëmijës ose familjes ndryshon në mënyrë dramatike;
- b. rreziku për fëmijë rritet; ose
- c. fëmija apo anëtarët e familjes nuk do të bashkëpunojë me planin e dakorduar.

Shembuj të veprimeve që mund të mbrojnë një fëmijë dhe të ndihmojnë prindërit/kujdestarët në kujdesin e duhur për fëmijën mund të përfshijnë:

- a. Aplikimi dhe marrjen e një certifikatë lindjeje për një fëmijë;
- b. Regjistrimi dhe sigurimi i pjesëmarrjes së përditshme të një fëmije në shkollë;
- c. Rregullta mjekësore kontrollet – në qoftë se një fëmijë ka një gjendje mjekësore dhe ka nevojë për të marrë ilaçe të përditshme psh diabeti, epilepsi, astma;

- d. Sigurimi i ofrimit të një karrige me rrota – në qoftë se një fëmijë ka një aftësi të kufizuar lëvizjen;
- e. Këshilla dhe mbështetje për një prind për të siguruar punësim;
- f. Duke punuar me një OJQ për të siguruar mbështetje apo aktiviteteve për fëmijën dhe / ose prindërit;
- g. Informacion mbi ndihmën financiare që familja ka të drejtë për të marrë;

5.2.5 Zbatimi, monitorimi dhe rishqyrtimi i PIM-it

Çdo institucion, autoritet apo ofrues shërbimi i përcaktuar në PIM është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve, të veprimeve, ndërhyrjeve apo ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në PIM për fëmijën, prindërit apo anëtarët e familjes së tij.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës:

- a) Referon zyrtarisht, me shkresë, të shërbimet e përcaktuara në PIM, rastin kur autoriteti përgjegjës nuk ishte prezent në mbledhjen e GTN-së;
- b) Kërkon informacion, sipas afateve të përcaktuara në PIM, për realizimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve e detyrave të tjera të anëtarëve të GTN-së dhe autoriteteve të tjera, të cilat është referuar rasti;
- c) Njofton drejtorin e strukturës përgjegjëse, në nivel vendor, në rastet kur koordinimi dhe ndërveprimi institucional në nivel vendor është i vështirë;
- d) Referon te Agjencia rastet kur autoritetet shtetërore nuk bashkëpunojnë e ndihmojnë në aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, me qëllim zbatimin e sanksioneve të parashikuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- e) Kryen rishqyrtimin formal të PIM-it, jo më vonë se 6 javë pas hartimit të PIM-it të parë dhe, më pas, çdo 3 muaj, por sipas nevojave të rastit ose kërkesës së njërit prej anëtarëve të GTN-së. Rishqyrtimi mund të bëhet më shpesh;
- f) Kryen vizita të rregullta në familje ose, në kuadër të masës së mbrojtjes, pranë institucionit, kujdestarit apo te personi pranë të cilit është vendosur fëmija, me qëllimin për të vlerësuar ecurinë dhe efikasitetin e ndërhyrjeve, të masave dhe shërbimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës merr informacion, në lidhje me:

- a) Fëmijën dhe marrëdhëniet e tij me familjen e origjinës, vëllezërit, motrat;
- b) Zbatimin e veprimeve dhe të detyrave të PIM-it dhe sa efektive kanë qenë ato;
- c) Rivlerësimin e nivelit të rrezikut dhe të nevojave të fëmijës dhe familjes;
- d) Hartimin e PIM-it të rishikuar.

PIM-i i rishikuar diskutohet në mbledhjen e radhës së GTN-së, e cila zhvillohet në të njëjtën mënyrë si mbledhja e parë. Anëtarët e GTN-së raportojnë lidhur me ofrimin e shërbimeve apo të ndërhyrjeve sipas PIM-it. PMF-ja, për rastet me rrezikshmëri të lartë, ka të drejtë të thërrasë GTN-në në takim të jashtëzakonshëm, pavarësisht takimit periodik të radhës.

PMF-ja përditëson të dhënat, në lidhje me rastin në formularin e shqyrtimit të progresit (aneksi nr. 8) dhe bën ndryshimet përkatëse në Planin Individual për Mbrojtjen e Fëmijës.

Plani Individual i Mbrojtjes së Fëmijës, i rishikuar, miratohet brenda 2 ditëve pune nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. PIM-i i rishikuar i dërgohet drejtorit, së bashku me formularin e shqyrtimit të progresit.

Monitorimi i PMF-i për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes

Drejtuesi i NJMF-së është përgjegjës për monitorimin e punës së PMF-së, në lidhje me zbatimin e PIMit, përfshirë PMF-në pranë NJMF-së apo PMF-në pranë njësisë administrative.

Drejtuesi i NJMF-së, i mbështetur nga PMF-ja përgjegjëse për ecurinë e PIM-it, realizon vizita monitoruese për të verifikuar situatën e fëmijës dhe të familjes së tij, me qëllim verifikimin e progresit në zbatimin e PIM-it.

NJMF monitoron zbatimin e Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës nga të gjithë aktorët. NJMF bën vizita të rregullta në familje, për të vlerësuar ecurinë dhe efikasitetin e ndërhyrjeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës. Rishqyrtimi formal i planit bëhet 6 javë pas hartimit të planit të parë dhe pastaj çdo 3 muaj, por mund të bëhet edhe më shpesh nëse është e nevojshme dhe nëse janë dakord anëtarët e Grupit Teknik Multidisiplinar.

Në takimet shqyrtuese e organizuara nga NJMF thirren të marrin pjesë, ata anëtarë të Grupit Teknik Multidisiplinar, të cilët ofrojnë shërbime sipas planit dhe që kanë njohuri mbi rastin. Për rastet me rrezikshmëri të lartë, të gjithë anëtarët e Grupit Teknik Multidisiplinar mbledhen dhe shqyrtojnë ecurinë e rastit, të paktën çdo gjashtë muaj.

Në takimet shqyrtuese analizohen veprimet dhe masat e ndërmarra për të vlerësuar nëse ato po zbatohen sipas planit, nëse janë akoma të nevojshme dhe nëse kanë nevojë për përshtatje në përputhje me nevojat në ndryshim të fëmijës dhe familjes. Në takimet shqyrtuese vlerësohet niveli aktual i rrezikut dhe rishikimi i Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës nëse është e nevojshme.

Formulari i Shqyrtimit të Progresit/Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës (Aneksi 7) përditësohet pas çdo takimi shqyrtues. NJMF dokumenton mbledhjet shqyrtuese në dosjet përkatëse.

5.2.6 Mbyllja e Rastit

Rasti mbyllet kur:

- fëmija është mbi 18 vjeç;
- ndërhyrjet e ndërmarra e kanë reduktuar nivelin e rrezikut, në rrezik të ulët ose mungesë rreziku;
- fëmija nuk gjendet më në atë situatë dhe kur nuk paraqiten rrethana që fëmija të kthehet në atë situatë rreziku përpara se të mbushë 18 vjeç;
- fëmija vdes;
- fëmija transferohet në një zonë tjetër dhe rasti transferohet për ndjekje tek një NJMF tjetër.

Rastet me rrezik të ulët mbyllet nga NJMF vetëm pasi është rënë dakord me eprorin dhe profesionistët që janë duke ofruar shërbime për fëmijën.

Për rastet me rrezik të mesëm, të lartë dhe të menjëhershëm, vendimi për mbylljen e rastit do të merret në takimin e Grupit Teknik Multidisiplinar. Plotësohet formulari për mbylljen e rastit (Aneksi 8).

Mbajtja dhe Raportimi i të Dhënave

NJMF mbajnë dy lloj të dhënash:

- Të dhëna individuale – informacion rreth rastit dhe menaxhimit të tij. Qëllimi i këtij informacioni është të ndihmojë punonjësit në zbatimin dhe monitorimin e planeve që të mbështesin fëmijën dhe familjet e tyre. Kjo dosje do të ofrojë informacion të rëndësishëm nëqoftëse rasti duhet të shqyrtohet (p.sh. nëse fëmija vdes) ose nëse merret një vendim nga gjykata në të ardhmen se kur duhet të ofrohet një përmbledhje e punës së bërë në familje. Gjithashtu shërben, nëse fëmija në një periudhë të mëvonshme, kërkon “historinë” mbi atë që i ka ndodhur.
- Të dhëna statistikore në lidhje me numrin dhe llojin e rasteve të menaxhuara nga NJMF, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore në fuqi, në mënyrë që bashkitë/komunat, NJDF, ASHMDF dhe SHSSH të kenë mundësi të monitorojnë zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës. Këto të dhëna do të ndihmojnë në identifikimin e tendencave lidhur me mirëqenien e fëmijës dhe për të ndihmuar në hartimin e evidencave për të advokuar për shërbime dhe fonde.
- Kërkesat e raportimit dhe mbledhjes së të dhënave statistikore janë të përcaktuara në aktet nënligjore dhe anekset.

Kur NJMF zgjidh shpejt një rast me rrezik të ulët dhe kur nuk ka rrethana për kontakte të mëtejshme me fëmijën dhe familjen, atëherë nuk është e nevojshme që të krijohet një dosje individuale për fëmijën, por puna e bërë duhet të paraqitet te formulari i referimit për mbrojtjen e fëmijës, (Aneks 2), Të gjitha kontaktet e NJMF me familjen duhet të regjistrohen.

Për të gjitha rastet në rrezik të mesëm, të lartë, të menjëhershëm, ose kur do të ketë kontakte të vazhdueshme me familjen për më shumë se vetëm disa ditë, krijohet dosja individuale e fëmijës.

Dosja individuale e fëmijës ka një numër individual dhe përmban:

- Fletët e Informacionit Bazë – Aneks 9 – (e cila duhet të përditësohet rregullisht dhe të mbahet në fillim të dosjes për t’iu referuar më me lehtësi);
- Formulari i Referimit për Mbrojtjen e Fëmijës - Aneks 2;
- Formulari i Vlerësimit – Aneks 4 (a, b, c, d);
- Formulari i Shqyrtimit të Progresit / Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës – Aneks 7;
- Formulari “Fletë të ditarit” - Aneks 10 - që japin në mënyrë të detajuar datat dhe orët e të gjithë kontakteve me familjen/fëmijën ose me anëtarët e Grupit Teknik Multidisiplinar përfshirë përmbledhjet e diskutimeve, takimeve dhe vizitave në shtëpi;
- Informacione të tjera të rëndësishme – si p.sh. certifikata e lindjes, vendimet gjyqësore etj.;
- Formulari i mbylljes së rastit – Aneks 8.

Të dhënat mbahen në hardcopy dhe në version elektronik. Të dhënat ruhen në një mjedis të sigurt të aksesueshëm vetëm nga NJMF. I gjithë informacioni i mbledhur nëpërmjet vlerësimit ose bisedave telefonike apo dhe në intervistat ballëpër ballë, duhet të regjistrohet sa më shpejt që të jetë e mundur pasi në këtë mënyrë sigurohet saktësia e informacionit

Të gjithë formularët e plotësuar me dorë duhet të plotësohen me stilolaps dhe jo me laps.

Konfidencialiteti

NJMF për shkak të rolit dhe funksionit dhe me qëllim menaxhimin e rastit, nuk mban sekret informacionin e marrë nga fëmija apo anëtarë të familjes, por regjistron këtë informacion në dosjet e tyre dhe ta përdorin për veprimet që do të ndërmarrin për zgjidhjen e rastit të fëmijës në nevojë, duke ruajtur konfidencialitetin dhe interesin më të lartë të fëmijës.

Fëmijët, kujdestarët dhe familjet përgjegjëse informohen për ndarjen e informacionit dhe i kërkohet të nënshkruajnë formularin e miratimit për ndarjen e informacionit, (Aneks 11) kur kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës. Kur një familje ose fëmijë nuk jep aprovimin për ndarjen e informacionit, por kjo gjykohet si e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e fëmijës, atëherë informacioni duhet ndarë edhe pa marrë miratimin e tyre.

Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve nuk duhet t'i premtojë fëmijës apo anëtarit të familjes se informacioni do të mbahet sekret. Fëmija duhet të njohë kufijtë dhe rolin e PMF dhe të kuptojë se i vetëm, Punonjësi, nuk mund ta mbrojë atë ose të ndryshojë situatën abuzuese në të cilën mund të ndodhet fëmija. Asnjë agjencie nuk i vjen në ndihmë premtimi që ta mbajë informacionin "të fshehtë". Gjithsesi duhet përmendur që informacioni do të ndahet vetëm kur do të jetë e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës dhe pasi të jetë informuar fëmija dhe familja.

Annex

Formatet e APLIKIMIT DHE VLERESIMIT TE AK <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2019/11/vendim-2019-11-11-722.pdf>

Formulari i Shqyrtimit të Progresit / Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës

FORMULARI I SHQYRTIMIT TË PROGRESIT / PLANIT INDIVIDUAL PËR MBROJTJEN E FËMIJËS		
Emri i Fëmijës:	Data kur është bërë Planit:	Data e Shqyrtimit të Radhës të Progresit:
Emrat e Personave që Plotësojnë Planin / Agjencia:		
Personi Përgjegjës për Monitorimin e Brendshëm të Planit (deri në Shqyrtimin e Progresit të Radhës)		
Plani i Pasigurisë: Çfarë veprimesh do të ndërmerren nëse plani nuk mund të zbatohet deri në shqyrtimin e radhës ose nëse situata e fëmijës ndryshon?		
Ju lutemi konfirmoni nëse prindërit / fëmija ishte i pranishëm (nëse jo si u morën në konsideratë mendimet e tyre gjatë hartimit të planit?)		
Datat e Shqyrtimeve të Mëparshme:		
<i>Shënim shqyrtimi duhet të ndërmerren – Shqyrtimi me Nr. 1 duhet bërë 6 javë pas planit të zhvillimit dhe më pas çdo 3 muaj.</i>		
<i>Ju lutemi rendisni nevojat e identifikuara në bazë të secilit dimension përkatës. JU LUTEMI referojuni vlerësimit dhe detajoni mënyrën sesi secili faktor risku do të ulet / eliminohet.</i>		

Dimensionet – Nevojat e Veçanta janë të Identifikuara.	Shërbimet e Nevojshme për të Përbushur Nevojat.	Agjencia Përgjegjëse & Afati Kohor.	Përditësim gjatë Shqyrtimit / Ndryshim i Planit.
Nevojat për Siguri:			
Strehimi / Akomodimi & Nevojat Bazë:			
Shëndeti & Nevoja për Zhvillim (duke përfshirë nevojat fizike, emocionale dhe psikologjike):			
Arsimi & Aftësitë e Jetës:			
Marrëdhëniet Sociale:			
Marrëdhëniet Familjare: (përfshirë si do të mbahen kontaktet nëse fëmija do të shkëputet nga familja)			
Kulturor / Identiteti:			
Nevojat për aktivitete çlodhëse:			
Çdo lloj tjetër i veçantë nevoje (p.sh. konsultime etj. Për të ndihmuar në përmirësimin e situatës):			

Bibliografi dhe referenca

I. Studime dhe manuale

1. Analiza e situatës të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri, Save The Children Albania, Tiranë, 2016.
2. Ç'rregullimi i spektrit autik, Save The Children Albania, Tiranë.
3. Family care for children with disabilities: practical guidance for frontline workers in low- and middle-income countries, June 2018, Save the Children.
4. Instrumentet e diagnostikimit të çrregullimeve neurozhvillimore te fëmijët e moshës 5-10 vjeç, Save the Children Albania, Tiranë.
5. Lista kontrolli për çrregullimet neurozhvillimore tek fëmijët e moshës 5-10 vjeç, Save The Children Albania, Tiranë 2016.
6. Përdorimi i instrumenteve të diagnostikimit të çrregullimeve neurozhvillimore te fëmijët e moshës 5-10 vjeç, Save the Children Albania, Tirana, 2017.
7. Udhëzues praktik për hartimin dhe zbatimin e planit edukativ individual (PEI) 2017, Save the Children Albania, Tirana, 2017.
8. Udhëzuesi i Terre des Hommes dhe Save the Children dhe Ndhmoni jetën - Udhërrëfyes për menaxhimin e sjelljeve problematike të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe dokumentimi i tyre, Tiranë, 2017,

II. Ligje dhe dokumenta strategjikë

- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Kodi i Familjes.
- Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji 57/2019 Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë.
- Ligji i ri 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
- Udhëzim i përbashkët i MMSR dhe MSH nr. 21, datë 7.10.2016 'Për miratimin e kriterëve për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar te të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot'.
- Udhëzim Nr. 597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara".
- Vendim Nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

- Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”.
- Vendim Nr. 822, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore”.
- VKM nr. 353, dt.12.06.2018 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative”.
- VKM Nr. 54, dt. 31.01.2018 “Për Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen”.
- VKM nr. 565, datë 29.9.2018 “Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
- VKM nr. 658, datë 17.10.2005 ‘Për Standardet e Shërbimeve Shoqërore’.
- VKM Nr. 91, dt. 14.02.2018 “Për Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.
- VKM Nr.148, datë 13.03.2018 “Për Përcaktimin e Rregullave të Bashkëpunimit ndërmjet Mekanizmave Këshillimorë e Koordinues Institucionalë, Strukturave për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Organizatave Jofitimprurëse, për Realizimin e Politikave Kombëtare e Vendore si dhe për shërbimet e Nevojshme për Mbrojtjen e Fëmijës”.

III. Legjislacioni në Shërbimin Social Shtetëror

1. Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”,
2. Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”.
3. Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit ”.
4. Ligji Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.
5. Ligji nr 22/2018 “Për Strehimin Social”.
6. Vendim nr.135 datë 07.03.2018, ‘Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”.

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit për programin e ndihmës ekonomike

Vendime të Këshillit të Ministrave:

1. Vendim Nr. 18, datë 12.1.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë”
2. Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike”

3. Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike"
4. Vendim Nr.257, datë 05.05.2021 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale"
5. Metodologjia e Kontrollit të NE (Shtojca 1)
6. Mekanizmat e standardizuar të raportimit për monitorimin e abuzimit dhe korrupsionit në skemën e Ndhmës Ekonomike (Shtojca 3)
7. Vendim Nr. 882, datë 24.12.2019 Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike
8. Vendim nr. 866, datë 24.12.2019 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj"
9. Vendim nr.305, datë 16.4.2020 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19"
10. Vendim nr.254, datë 27.3.2020 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19"
11. Vendim nr.305, datë 16.4.2020 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19"
12. Vendim nr. 13, datë 22.4.2020" Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.305, datë 16.4.2020, të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19"
13. Vendim nr. 423, datë 28.5.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.305,datë 16.4.2020, të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19"
14. Vendim nr.85, datë 10.02.2021, "Për një shtesë në vendimin nr.597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave , "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike."
15. Vendim Nr. 617, datë 20.10.2021 "Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre"
16. Vendim Nr. 868, datë 29.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"

17. Vendim nr.159, datë 12.3.2022 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë"
18. Vendim nr.617, datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar."
19. Vendim nr. 751, datë 1.12.2022 për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç
20. Vendim nr. 754, datë 1.12.2022 për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit 2022
21. Vendim nr. 899, datë 29.12.2022 për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e impaktit të krizës
22. Urdhër i përbashkët nr.52, datë 26.01.2022 "Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune"
23. Urdhër i përbashkët nr.148, datë 28.02.2022 "Për ngritjen e grupeve rajonale të punës për vlerësimin, referimin për punësim dhe integrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike"
24. Vendim Nr. 174, datë 24.3.2023 "Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023–2025"
25. Vendim nr. 234, datë 20.4.2023 për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2023

Udhëzime të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

1. Udhëzim nr.47, dt.11.01.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008, "Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar"
2. Udhëzim Nr. 3, datë 17.02.2017 mbi zbatimin e Vendimit Nr.955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për Përcaktimin e kriterëve,të procedurave,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike"
3. Udhëzim Nr. 4, datë 17.02.2017 "Për Përllogaritjen e Përfitimit të Ndhmës Ekonomike"
4. Udhëzim nr. 5,datë 17.02.2017 " Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind."
5. Udhëzim Nr.8,datë 08.05.2017 ,Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr.3,datë 17.02.2017 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr.955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e Kriterëve, të Procedurave, Dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike".
6. Udhëzim Nr.714, datë 11.10.2018 për "Metodologjinë e Kontrollit të Pagesës së Ndhmës Ekonomike.
7. Udhëzim Nr.715, datë 11.10.2018 për "Mekanizmat e Standartizuar të Raportimit për Monitorimin e Abuzimeve dhe Korrupsionin në Skemën e Ndhmës Ekonomike."

8. Udhëzim nr.870, datë 24.12.2018 për "Përcaktimin e Veprimeve dhe Proçedurës që Kryejnë Nëpunësit e Zyrave Të Gjendjes Civile dhe Personi i Autorizuar Pranë Institucionit të Shërbimit Spitalor Për Përfitimën e Masës së Ndhmës së Menjëhershme Financiare për Nënata me Foshnja të Porsalindura"
9. Udhëzim nr.117 datë 25.02.2020 "Për Miratimin e Programit të Rimëkëmbjes Shëndetësore dhe Sociale"
10. Urdhër nr.213/1, datë 01.09.2020 "Për marrjen e masave të veçanta nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 për aplikuesit dhe përfituesit e ndihmës ekonomike."
11. Urdhër nr.178 datë 21.09.2020 " Mbi zbatimin e Vendimit nr.597 datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"
12. Udhëzim nr.670, datë 13.12.2022 "Për procedurën e aplikimit dhe përfitimit nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç."
13. Udhëzim i përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023 "Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit"
14. Urdhër i Ministrit për Çështjet Sociale nr.52 dt.11.01.2018 për ekzaminimet dhe organizimin e komisioneve mjekësore rajonale të caktimit të aftësisë për punë.

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit për programin e pagesave të personave me aftësi të kufizuar

Vendime të Këshillit të Ministrave:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.277, datë 13.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar.
2. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.31 datë 20.01.2001, "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar.
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.618, datë 07.09.2006, "Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar..
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.869 datë 18.06.2008, "Për zbatimin e Ligjit Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit ".
5. Vendim Nr.431, datë 08.06.2016 "Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot".
6. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre"
7. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 182, datë 26.02.2020 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës së personave me

Aftësi të Kufizuara, si dhe të ndihmësit personal.

8. Vendim nr.707, datë 09.09.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal"
9. Vendim nr.675, datë 02.09.2020 " "Për një ndryshim në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997, të këshillit të ministrave, "për përfitimet nga statusi i të verbërit", të ndryshuar"
10. Vendim Nr.257, datë 05.05.2021 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale"
11. Metodologjia e Kontrollit të Vlerësimit bio-psiko-social të Aftësisë të Kufizuar. (Shtojca 2)
12. Vendim nr. 616, datë 22.9.2022 për disa ndryshime në vendimin nr. 404, datë 20.6.2012, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse"
13. VENDIM Nr. 874, datë 24.12.2019 PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË NDIHMESËS PERSONALE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NDIHMËSIT PERSONAL

Udhëzime të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

1. Udhëzim i Ministrit Nr.2365, datë 26.11.2008 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr.277, datë 13.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit"
2. Udhëzim i Ministrit Nr. 1406, datë 30.07.2008 "Për përcaktimin e proceduarve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të Vendimit Nr.869 datë 18.06.2008, "Për zbatimin e Ligjit Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit "
3. Udhëzim nr.17, datë 30.08.2016 "Mbi zbatimin e vendimit nr.618, datë 07.09.2006, të këshillit të ministrave për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar.
4. Udhëzim nr.19, datë 30.08.2016 "Mbi zbatimin e vendimit nr.31, datë 20.01.2001, të këshillit të ministrave, "Për përfitimin nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar"
5. Udhëzim nr.18, datë 30.08.2016 "Mbi zbatimin e vendimit nr.277, datë 18.06.1997, të këshillit të ministrave, "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", të ndryshuar"
6. Udhëzim Nr.22, datë 7.10.2016 "Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së Aftësisë së Kufizuar e të ndihmësit personal".
7. Udhëzim Nr.21, datë 07.10.2016 "Për miratimin e kriterëve për vlerësimin bio-psikosocial të aftësisë së kufizuar tek të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot".
8. Urdhër Nr.Nr. 47/1, datë 11.1.2018 " Për miratimin e rregullores "Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë Punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë"
9. Urdhër nr.52, datë 11/01/2018 "Për Ekzaminimet dhe Organizimin e Komisioneve Mjekësore Rajonale të Caktimit të Aftësisë Për Punë"
10. Udhëzim nr. 667, datë 01.10.2019 "Për metodologjinë e kontrollit të vlerësimit bio-psikosocial të aftësisë së kufizuar"

11. Urdhër nr.266/1, datë 01.09.2020 " Për marrjen e masave të veçanta nga Komisionet e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar dhe Invalidëve të Punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19
12. Urdhër nr.515 datë 18.09.2020 " Për disa ndryshime në udhëzimin nr.2356, datë 26.11.2018 mbi zbatimin e Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997 " Për përfitimet nga statusi i të verbërit" i ndryshuar.
13. Urdhër nr.178/1 datë 21.09.2020 "Mbi zbatimin e vendimit nr.277, datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit" i ndryshuar.
14. Urdhër nr.178/2 datë 21.09.2020 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e Aftësisë së Kufizuar dhe Ndhmësit Personal dhe të strukturave përgjegjëse e detyrave të tyre"
15. Urdhër nr.178/3 datë 21.09.2020 "Mbi zbatimin e vendimit nr.182, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me Aftësi të Kufizuar, si dhe ndihmësit personal", të ndryshuar.
16. Urdhër nr.178/4 datë 21.09.2020 "Mbi zbatimin e vendimit nr.31 datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar.
17. Urdhër nr.577, datë 14.10.2020 "Për një ndryshim dhe shtesë në urdhërin nr.266/1, datë 01.09.2020, për marrjen e masave të veçanta nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 .
18. Urdhër nr.246, datë 13.09.2021 " Mbi zbatimin e vendimit nr.722, datë 11.11.2019, të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre"
19. Urdhër nr.246/2, datë 13.09.2021, "Mbi zbatimin e vendimit nr.31 datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave " Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar.
20. Urdhër nr.246/3, datë 13.09.2021,"Mbi zbatimin e vendimit nr.182 datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e kriterëve të procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmësit personal" të ndryshuar.
21. Urdhër nr.246/4, datë 13.09.2021, "Mbi zbatimin e vendimit nr.277, datë 18.06.1997" Për përfitimin nga statusi i verbërit të ndryshuar."
22. Urdhër nr.222/1, datë 31.08.2022 "Mbi zbatimin e vendimit nr.182 datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e kriterëve të procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmësit personal" të ndryshuar. Urdhër nr.222/2, datë 31.08.2022 "Mbi zbatimin e vendimit nr.277, datë 18.06.1997" Për përfitimin nga statusi i verbërit të ndryshuar. Urdhër nr.222/3, datë 31.08.2022 "Mbi zbatimin e vendimit nr.31 datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar.
23. Urdhër nr.222/4, datë 31.08.2022 " Mbi zbatimin e vendimit nr.722, datë 11.11.2019, të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për

vlerësimin dhe përfitim të aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”

24. Udhëzim nr.458, datë 26.07.2022 “Për procedurën e hedhjes së të dhënave dhe dokumentacionit në Arkivën e Regjistrat Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar”
25. Urdhër i përbashkët nr. 211, datë 04.04.2022 “Për miratimin e planit të masave për punësim të personave me aftësi të kufizuar”

IV. Webliografi

www.albania.savethechildren.net

www.helpthelife.org

www.qbz.gov.al

www.shendetesia.gov.al

www.sherbimisocial.gov.al

www.tdh.org

www.uogj.edu.al

www.who.int

www.wvi.org